

# KOSOVARJA

Ballina: Shkenda Dubova  
Foto: Ard Dubova

**Cili politikan  
ma gërditi  
Shqipërinë**

**Pse Kurti  
kurrë  
nuk flet  
për dashuri**

**Mirosla  
mbushet  
me nipër  
nga Turqia**

**20 FAKTE PËR FEMRËN  
MË TË FUQISHME SHQIPTARE**

*Shkenda Dubovën*

**Pse  
më të suksesshmet  
janë nga Peja**

**Ku ndodhet  
mbesa e  
Nexhmije  
Pagarushës**

**Simoneta  
Bajrami,  
nuse  
madhështore**

**Rifat Osmani,  
dentisti shqiptar  
që bën revolucion  
në Zvicër**





# DINO COMPANY

MAGJISTRALJA PRISHTINE-FERIZAJ km-2, 14000 LIPJAN, KOSOVË

+383 44 206 586  
www.dino-company.com

Dino keramika, është kompani e cila ofron produkte me shumice dhe pakicë, nje game të gjere të llojeve të keramikës të cilat vijnë nga fabrikat me të njohura italiane dhe spanjolle ; "mirage", "azuvi", "ecoceramic"

Strukturë dhe ngjyrë të veçantë, efekte që kënaq shijet dhe nevojat estetike, kombinime të koordinuara, kontraste dhe përshtatje.




NUK LËSHOJNË  
KOMPONENTE  
TË DËMSHME

ARMIQ  
NDAJ  
BAKTERIEVE

NUK  
PËRBEJNË  
ALERGJI

PASTROHEN  
LEHTË

NUK LËSHOJNË  
KOMPONENTE  
TË DËMSHME



info@brezovicahotel.com  
www.brezovicahotel.com





## Adelina Hasani ecë pa u ngutur, por sigurt

Adelina Hasani është ndër prezantueset më të njohura e më atraktive të televizionit në Kosovë, që për vite me radhë prezanton formate të ndryshme televizive, kurse moderimi i saj gjithmonë ka qenë në nivel.

Ishte pjesë e KTV-së, pastaj e TV "T7", ku punoi dhe kontribuoi një kohë, ndërkaq tash është aktive dhe shumë e suksesshme gjatë këtij sezoni veror në ATV, në emisionin e orëve të mbrëmjes.

Ajo flet, bën pyetje, i menaxhon të gjitha situatat në studio dhe duket fresh, natyrale dhe tejet e bukur.

Me buzëqeshje të lehtë dhe shumë natyrale, por edhe me pyetjet shumë interesante e spontane dhe me bashkëbisedues atraktivë, të "gozhdon" para ekranit televiziv dhe të nxitë t'i shikosh të gjitha emisionet e saj, e që gjithmonë janë interesante.

Pra, ecë pa u ngutur, por sigurt...



Flash

## Kush ia ndaloi këngën Mirsa Kërçelit?



Dikur ishte njëra prej këngëtareve më të kërkuara në tregun e muzikës shqiptare. Vlerësohej për zë të mirë të gjeneratës së re. Por, ka vite e vite që është "zhdukur" nga skena. Dhe, duke mos qenë prezent në media e në muzikë, natyrshëm lind edhe pyetja pse e la muzikën. Disa thonë se në ndërprerjen e karrierës së këngëtares ka ndikuar bashkëshorti dhe martesja e saj, e disa thonë se është përkujdesja ndaj fëmijëve. A thua?

Në ballinë:

*Femra e artë*

20

fakte

për femrën

më të fuqishme

shqiptare

*Shkenda Dubovën*

Shkenda Dubova është fenomen në botën e biznesit, meqë në moshë të re është bërë një nga femrat e fuqishme dhe tejet të suksesshme, duke hapur disa Qendra Dobësimi me emrin e saj në Kosovë, por edhe në vende të ndryshme të Evropës.



Shkenda Dubova është shndërruar në brend, falë punës kolosale që bënë. Në Qendrat e Dobësimit të Shkendës, njerëzit me mbipeshë gjejnë formulën e suksesit për të fituar linjën ideale, për t'u ndjerë komod me veten para pasqyrës dhe për të gëzuar shëndet dukshëm më të mirë. Shkendën, këngëtaren, biznesmenen e nutricionisten, Zoti e ka pajisur me shumë virtyte pozitive, madje e ka larë në ar, siç thuhet në popull. Për imazhin e këtij numri të "Kosovares", 20 fakte interesante të Shkenda Dubovës, që nga fëmijëria e deri më tash...

1. Ka qenë fëmijë energjik dhe shpesh është fshehur në vendet ku mezi e kanë gjetur;

2. Babanë e ka fotograf e kameraman dhe ka fotografuar çdo moment të fëmijërisë së saj. Ajo është tamam "çika e babit";

3. Ka filluar të punojë që nga mosha 12 vjeç, në studion e babait, ku ka qenë tejet e përkushtuar. Më vonë ka pasur butikun "Kendi Shop";

4. Në moshën 16 vjeçe u bë "vajza e spektakleve të bukurisë". Mori pjesë në "Miss Gjilani", "Miss Kosova" dhe "Miss Shqipëria". Ishte pjesëmarrëse edhe në kompeticione bukurie me karakter ndërkombëtar, si "Miss bikini World" dhe "Miss Universe", ku edhe ka fituar "Miss Press" dhe "Miss fotogenia". Tregon se i ka pëlqyer vëmendja, televizioni dhe fama;

5. Nënë e do shumë, por pranon se është e rreptë, kritikuese, ani pse krenare me të arriturat e të bijës;

6. Motrën, Dafinën, e quan krahë të djath-të të saj. Është si hije që e ndjekë. Është ajo që nuk mund ta ndajë nga shpirti i saj. Vëllai, Ardiani, është krenaria e Shkendës, është shtylla e familjes. Ai e kupton dhe e mbështet gjithmonë;

7. Në moshën 21 vjeç i erdhi ideja për të pasur një biznes të saj, që për qëllim kishte dobësimin e njerëzve. Qendra e Dobësimit u jetësua shumë shpejt, për t'u bërë një sukses gjigant me përmasa ndërkombëtare;

8. Tregon se në fillet e biznesit sukcesi dhe as aparatura që përdorej në Qendrën e Dobësimit nuk ishte kjo që është sot, që i përket fjalës së fundit të teknologjisë. Ndonëse njerëzit nuk kanë besuar se si mund t'i heqin 10 kg për 15 ditë, Shkenda nuk është ndalur në rrugëtimin e saj derisa i ka bindur dhe ua ka bërë ëndrrën realitet shumë personave për të pasur linja perfekte;

9. Për të hapur biznesin, e që tashmë njihet shumë, i është dashur të shesë ve-turën dhe gjëra të tjera të saj. Më tej, për të investuar dhe për të arritur standardin që ka tash, është dashur të marrë kredi. Por, sakrificat ia ka vlejtur;

10. Për një investim kapital, meqë banka ia refuzoi kredinë, ia zuri derën dhunshëm drejtorit të bankës dhe ia sqaroi ëndrrën, projektin. Kredia iu aprovua. Dhe, tash bi-zneset e Shkendës kanë suksesin e vulosur dhe ka licencën për Evropë;

11. Dhe, tash programi i dobësimit "Shkenda Dubova" është program i patentuar dhe op-eron në shumë shtete të botës ... Edhe tregu ndërkombëtar është mahnitur me rezultatet të cilat japin këto qendra të dobësimit;

12. Ajo po punon në krijimin e një linje organike që shumë shpejt do të jetë në të gjithë botën. Duket interesante, por nuk ndanë shumë detaje;

13. Karriera e Shkenda Dubovës në muzikë është e njohur dhe brilante. Kënga "Tutu" i hapi rrugë në botën e muzikës. Ndërkaq, "Ditëlindja" është një tjetër konfirmim i suksesit të gjilanasës së bukur;

14. Videoklipet e Shkendës janë inves-time marramendëse. Ajo nuk ka kursyer asnjëherë që projektet e saj të kenë gjithë shkëlqimin e mundshëm;

15. I ka ra pishman që gjatë karrierës së saj i ka bërë një herë flokët të bardha. Tregon se i ka hequr disa videoklipe ku ajo ishte bionde. I duket se ajo kohë ishte dalje jashtë vetes;

16. "Si dikur", bashkëpunimi me Rikin, është kënga e saj e fundit që u bë hit, shoqëruar me videoklip me kosto të lartë, gjë që edhe duket. Kjo këngë u tha se e përmbyllë karrierën muzikore të Dubovës. Por, si duket, gjërat ende nuk janë defi-nitive në këtë drejtim;


17. Thuhet se është vetëm, pa partner në krah. Sipas Shkendës, dashuria vjen vetvetiu, të rrëmben dhe nuk të pyet je apo nuk je gati;

18. Nuk dëshiron që burri i saj të jetë i famshëm. Sidomos, jo i famshëm në fushën e muzikës ose aktrimit;

19. Ka raporte të shkëlqyera me kolegë. Me askënd nuk ka pasur ndonjë konflikt. Të gjithë e duan Shkendën;

20. Emri i Shkenda Dubovës tashmë është brend.

A.D.





Mustafa Qemal/Ataturku:



Mehmet Ali Shqiptari



Mbreti Faruk i Egjiptit

## MUSTAFA QEMAL ATATURKU:

# “Neve, shqiptarëve, na paska lindur nëna vetëm t’ua ngremë flamujt shteteve të huaja!”

“Qyteti i Tetovës, përveç personaliteteve të tjerë të shquar, me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare, edhe Perandorisë Osmane, më vonë Republikës së Turqisë, i ka dhënë disa dijetarë e ushtarakë të mëdhenj, mes të cilëve edhe gjeneralin e famshëm Hajrullah Fishekxhiun. Hajrullahu, i lindur në Tetovë më 3 qershor 1885, ka ndërruar jetë në An-

kara të Turqisë, më 13 korrik 1975. E, të mos i përmendim të tjerët: sa e sa kryeministra të Turqisë me prejardhje shqiptare, mbretin Faruk të Egjiptit, motrën e tij Fevzia, si gruaja e parë dhe, njëkohësisht, ish-mbretëreshë e Iranit, duke qenë bashkëshorte e Shahut të Iranit, Mohammad Reza Pahlavi, e cila vdiq në moshën 91-vjeçare në vitin 2013; Mehmet Ali Pashën-

Shqiptarin (1769-1849), i cili themeloi dinastinë shqiptare të Egjiptit, e cila zgjati deri në vitin 1952 etj. Por, me këtë rast, zëmë ngoje fjalët e shqiptarit të madh Mustafa Qemal Ataturku, themeluesit të Turqisë moderne: “Neve, shqiptarëve, na paska lindur nëna vetëm t’ua ngremë famën dhe flamujt shteteve të huaja!”. Shtrohet pyetja: Për vendin tonë, çka?!

**Pronar dhe botues:**  
Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**  
Isa ILAZI

**Menaxher:**  
Driton DILI

**Redaksia:**  
Safet Krivaça (reporter i lirë)  
Nderim Neziri (redaktor)  
Besiana Dili  
Drenushë Haredinaj  
Rilinda Krasniqi  
Ardita Dili

**Dizajni:**  
Labinot Bërbatovci

**Adresa e redaksisë:**  
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë  
**Tel:** 038 51 75 75  
**Email:** [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**  
Tel: +383 44 143 448;  
**Email:** [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)



# NUK E KISHA KUPTUAR JETËN

Është provuar se pasioni i shfrenuar për pushtet e prish njeriun. Por, ata që nuk i njohin vlerat njerëzore janë të prishur vetë. Ata vetëm presin rrethanat e favorshme për të hequr mbulesën e çnjerëzimit të tyre. E, rrethanat në Kosovë janë bërë të favorshme për ta. Andaj, edhe kanë të drejtë ata që thonë se miqtë e Kosovës janë më të interesuar ta forcojnë shtetin tonë se sa vetë ne, shqiptarët. Ne sikur nuk po e dimë, as që duam ta dimë, as ta kuptojmë, se pushteti është një përgjegjësi dhe jo një vend pune.

\*  
Çdo mbret i madh ishte një fëmijë që qante dhe çdo ndërtesë e madhe ishte vetëm një plan në letër. Nuk është me rëndësi se në çfarë gjendje je sot, por me rëndësi është që ta avancosh veten dhe të vendosësh se çka do të jesh nesër...

Çka do të jesh nesër për vete, për fëmijët e tu...

\*

Një mendim i pëlqyer: Në planetin tonë jetojnë edhe gjallesa helmuese që helmojnë njerëzimin e kombet.

\*

Kur isha shtatë vjeç, nëna më thoshte e ma përsëriste gjithmonë: Lumturia është çelësi i jetës!

Kur shkova në shkollë, mësuesi më pyeti çka do të dëshiroja të bëhem kur të rritem. Unë nuk iu përgjigja fare. E lash faqen bardhë, pa e shkruar dëshirën time. Mësuesi, me të parë që unë nuk isha përgjigjur fare, më tha se nuk e kisha kuptuar pyetjen apo pse nuk isha përgjigjur. Unë iu gjegja: "Ende nuk e kam kuptuar jetën!"

**Gani Dili**



# Pse dashurinë e parë e kujtojmë vetëm për mallkim e urrejtje?

*Për të harruar dashurinë e parë, ndonjëherë, varet nga përvojat që ke pasur. Dikujt dashuria e parë mund t'i ketë dhënë shumë dhimbje, dikujt urrejtje, prandaj edhe mbetët gjithmonë në mendje.*

*Ç'thonë të anketuarit tanë në këtë temë?*

**VIRXHINIA, NGA PRISHTINA, 24 VJEÇE, E MARTUAR PRA NJË VITI:**

**DASHURIA E PARË ËSHTË VULLKAN!**

- Për të harruar dashurinë e parë, nganjëherë, varet nga përvoja që ke pasur. Dikujt dashuria e parë mund t'i ketë dhënë dhimbje, dikujt urrejtje, e dikujt diçka tjetër. Dhe, këto janë shkaqet që, ndoshta, ajo mbetët gjithmonë në mendje... Dikujt tjetër mund të mos i hiqet nga mendja pamja e të dashurit a të dashurës dhe i kujtohet vazhdimisht. Pra, e tëra varet edhe nga krijimi i situatave të krijuara nga të dashëruarit.

Personalisht, edhe pse që një vit jam martuar, me plot bindje them se dashuria e parë nuk harrohet, edhe pse mua më ka ndodhur të dashurohem në vitin e parë të shkollës së mesme, kur ende isha adolesh-

ente dhe e desha me shpirt një shok dy vjet më të vjetër se unë. Por, tash ai është jashtë, kurse unë e kam gjetur dashurinë time të vërtetë dhe kam krijuar familje.

**VYRTYTI, NGA GJILANI, 26 VJEÇ, I PAMARTUAR: S'HARROHET VENDI KU E KE BËRË SEFTE!**

- Jam në lidhje me të dashurën time që e dua shumë. Por, edhe pse i dashëruar marrëzisht në të, ende nuk kam arritur ta lë në harresë të dashurën e parë, me të cilën isha në lidhje deri para dy vjetësh. Kam përshtypjen se vetëm dashuria e parë s'harrohet kurrë, pavarësisht si ka qenë: e mirë a e keqe, pak ka rëndësi. Gjatë jetës sime, edhe pse nuk kam ndonjë përvojë të madhe, mendoj se mund të dashurohesh shumë herë, të kesh përvojë të mirë seksuale, mirëpo hera e parë ende

më ka mbetur në kujtesë si përvoja më e mirë seksuale, sepse shoqërohej me emocione të veçanta.

Nuk di pse ndodh kështu, por s'harrohet dot hera e parë kur e bën sefte! Vazhdimisht të kujtohet vendi ku e ke bërë sefte, por edhe momenti i ndarjes...

**ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË?**

Hera e parë s'mund të harrohet vetëm se është përvojë e diçkaje të panjohur që e kemi bërë. Shumë herë dashuritë që vijnë më vonë janë shumë të fuqishme dhe lënë mbresa e kujtime më shumë sesa hera e parë.

Megjithatë, jeta është e gjatë dhe harrohet dashuria e parë, harrohet e dyta, harrohet edhe e treta... Dhe, vetëm ajo që krijojmë familje të lidhë me mish e shpirt me jetën, me realitetin...

**Diturie Haxhaj**







*“M’i vranë dy djemtë e mëdhenj në livadh. Sytë dhe gojën ua mbulovala me lecka, sepse rreth tyre silleshin miza të shumta. Djalë e vogël, 12 vjeç, e gjeta në Tiranë. Kishte arritur t’u shpëtonte plumbave. Atë ditë m’u freskua zemra në Tiranë. Por, tash, Edi Rama me Aleksandër Vuçiçin e Goran Bregoviçin ma kanë gërditur Tiranën, ma kanë gërditur Shqipërinë!”.*

# Cili politikan ma gërditi Shqipërinë?!

“Mos ma përmendni emrin. Ndoshta jam rrallë e s’po di me fol. Alia të tregon çka kam hequr në luftë, qysh i kam pa mizat mbi xhenaze...”, nis rrëfimin Ferati, nga Ballabani i Prishtinës, në kampin e Tiranës më 1999, teksa i fshinte lotët. Aliu, një burrë rreth të gjashtëd-

hjetave, vazhdoi rrëfimin e ngjarjes, në praninë e plakut, të cilit para syve dhe gruas serbët ia vranë dy djemtë e mëdhenj. Në fund të prillit të vitit 1999, paramilitarët serbë marrin pengë banorët e një lagjeje të Ballabanit të Prishtinës dhe i detyrojnë të rreshtohen në livadh, pranë për-



roit të malit. Pas një kohe, forcat  
çetnike fillojnë t'i nxjerrin djemtë  
e ri nga rendi dhe t'i pushkatojnë  
në përrua.

"I merrnin dhe i ofronin në cep  
të përroit dhe ua lëshonin rafalët  
në trup, duke i lënë të vdekur.

Disa binin menjëherë në përrua  
të vdekur, e disa dëgjoheshin  
kah gjëmonin...", thotë Ali Zeneli,  
nga Ballabani dhe shton:

"Kur i erdhi radha Feratit dhe  
familjes së tij, ai tha: "Ishalla më  
vrasin mua të parin e nuk shoh  
çka bëhet me djemtë!"

Por, çetnikët dinin si t'ua digjnin  
zemrat prindërve. Kur erdhi  
radha t'i merrnin djemtë e tij,  
çetnikët iu ofruan plakut me plis  
dhe i thanë:

"Çka i ke këta tre?"

"Djem i kam".

"Afrohuni ju të dyl", urdhëruan  
paramilitarët dy më të mëdhenj-  
jtë.

Plaku u tha çetnikëve:

"A bën, bre axhë, me i falë  
djemtë e mi, e me më marr mu  
në vend të tyre? Edhe unë kam  
shpirt dhe merreni shpirtin tim...".  
Serbët e kuptuan qëllimin e pla-  
kut dhe i thanë:

"Jo, jo, edhe ti ke shpirt, por je  
plak e nuk kemi punë me pleq,  
por me këta që po na vrasin".  
Dhe, pasi i morën djemtë, ende  
pa i ofruar mirë të përroi, u ranë

plumba në livadh, duke i lënë të  
dy të vrarë", tregon Aliu.

## DJALI I VOGËL U FSHEH NDËRMJET KUFOMAVE...

Dhe, pas vrasjes së dy djemve të  
mëdhenj, brenga e Feratit dhe  
e plakës së tij ishte se çka do të  
bëhet me djalin e tyre të vogël.  
Me t'u zbrazur rafalët e serbëve  
në trupat e dy vëllezërve të  
mëdhenj, ai ikë. Hidhet në për-  
rua sikur i thoshte Zoti - ikë se të  
mbroj unë...

"Ndal! Hej ti, ndal, ku shkon?!",  
bërtiti njëri nga policët dhe  
shkrepi një rafal automatiku në  
drejtim të tij.

Njëri prej policëve tha:

"E pat edhe ai!".

Po i njëjti polic i tha plakut:

"Të voglin s'deshëm të ta vrasim,  
por e lyp vetë!".

"Qysh ka thënë Zoti - ai m'i ka  
falë dhe ai m'i merr. I kam gjet si  
vonë, por nuk qenka shkru me i  
pasë!", ia ktheu plakut.

Kur çetnikët e bënë të veten, u  
larguan. Plaku ua mundua t'ua  
mbulonte fytyrat djemve, sepse  
mizat sillleshin vërdallë. Pastaj,  
nisi të ecte përroit që ta gjente  
djalin e vogël...

Por, trupin e djalit të vogël nuk e

gjeti kund...

Pas ofensivës, njerëzit që  
ndodheshin përreth, shpejt  
e shpejt i varrosën kufomat,  
sepse kishte rrezik të kthe-  
heshin policët sërish...

## SI ARRITI TË DILTE PLAKU NË SHQIPËRI?

Me kolonën e gjatë të njerëzve,  
plaku me plakën dhe Ali Zeneli  
me familje arritën në Shqipëri  
dhe i vendosën në kampin e  
Tiranës.

Plaku çdo ditë dilte në skaj të  
kampit dhe zhgrehej në vaj. A  
thua, çka ka ndodhur me djalin  
e vogël, e sillte në mendje dhe  
lotët i shkonin rrëke.

"O, axhë, pse qan?", e pyet një i ri  
i vendosur edhe ai në kamp.

Plaku ia tregon historinë e  
tragjedisë, pikë për pikë...

"Kështu s'mund ta gjesh. Duhet  
t'i pyesësh ata që shpërndajnë  
bukë, sepse i kanë emrat e atyre  
që marrin bukë çdo ditë ose të  
rrish te vendi ku shpërndahet  
buka dhe të shikosh mos ndod-  
het djali yt këtu. Nëse është në  
kamp ai vjen me marrë bukë", ia  
ktheu i riu.

Dhe, që nga ajo ditë, plakut çdo  
ditë shkonte te vendi ku shpërnda-  
hej buka. Në ditën e pestë, si





prej qielli piku djali i vogël i plakut. Plaku e pa nga larg dhe u nis drejt tij, me një droje se mos nuk ishte ai, por vetëm i ngjasonte...

## SI TA PËRMBYLLË KËTË SHKRIM?

Gjatë kohës së luftës Shqipëria na doli në ndihmë më shumë se çdo shtet tjetër. Ata që arrinin të dilnin në Shqipëri e konsideronin veten me fat, sepse plumbat e serbëve nuk arrinin atje...

Por, tash, në krye të Shqipërisë është Edi Rama, i cili e pret ngrohtë në çdo takim Aleksandër Vuçiçin, e që ishte pjesë e shtetit që vrau shqiptarët e Kosovës!

Vuçiçi është po ai që ishte dikur: e qorton Kosovën pse nuk inkuadrohet në "Minish-engenin ballkanik"! E, Edi Rama nuk ia prish tullugun e duhanit mikut të tij serb. Edhe ai e qorton Kosovën me fjalët "Boll më me fjalët: Nuk na kanë ftuar, na kanë ftuar!"

E, po ai Edi Ramë, që para pak vjetësh i dha "Çelësin e Tiranës" Goran Bregoviqit, këngëtarit që u kushtoi himne vrasësve serbë në Kosovë, tash e fton po të njëjtin në një manifestim në Korçë, me rastin e festës së birrës, duke lënduar mijëra e mijëra shpirtra shqiptarë të Kosovës dhe duke shkelur mbi gjakun e mijëra dëshmorëve të Kosovës...

Por, erifi po e këqyrë punë e vet dhe po thotë nuk duhet të bimë viktimë të së kaluarës...

Dhe, kjo ma kujton dashur e pa dashur mbretin Zog, i cili, për të ardhur në krye të shtetit shqiptar, rrëzoi qeverinë e Nolit me ndihmën e mbretit të Serbisë.

**Safet Krivaça**



# Pse më të suksesshmet kosovare janë nga Peja?

*Të afirmuarat kosovare: Rita Ora, Dua Lipa, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Lorian Kuka, të gjitha me origjinë nga Peja... Interesante, a?*



Rita Ora, Dua Lipa, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Lorian Kuka kanë të përbashkët se të gjitha janë të suksesshme në rrafshin global, por edhe se janë me origjinë nga Peja dhe secila e ka

emrin më të bukur e më shqip se tjetra. Me frymëzim e edukim familjar, kulturë urbane të shoqëruar me shumë punë, ambicie, e mbi të gjitha lirinë kolektive që kanë femrat pejane nga

familja e rrethi, janë arsyet për sukseset e tyre.

Dhe, mu kjo liri ka ndikuar që edhe në botën e bukurisë pejanet dallohen, si në garat për mis apo ato të modelimit...





*Po të mos kishin guxim të kërcenin nga kamioni, edhe tre të mbijetuarit e masakrës së Therandës nga familja Berisha, do t'i mbulonte dheu i varrezës masive, ashtu siç u mbuluan edhe të ngarkuarit e tjerë, e që i ngarkuan njërin mbi tjetrin, në mesin e të cilëve pati edhe të plagosur.*

## Si shpëtuan Shyhretja, Vjollca dhe Gramozi nën kufomat?

Gati dy vjet e gjysmë pas krimit, kur edhe e vizituam këtë familje, familja Berisha në Therandë pret zbulimin e anëtarëve të zhdukur, pas krimit që ndodhi në Qendrën Zejtare në Therandë, kur grupit prej 50 shqiptarëve, në mesin e të cilëve shumë gra e fëmijë, i shpëtuan tre vetë: Vjollca, Shyhretja

dhe Gramozi.

Dëshmitarët e gjallë, e që i kanë shpëtuar krimit, dëshmojnë se krimet mbi Berishët në Therandë i kanë kryer fqinjët e tyre, në bashkëveprim me mercenarët rusë, romë etj.

Nuk është fshehtësi për therandasi, por as për opinionin tjetër,



Gramoz Berisha me nënën e tij

se krimet në Qendrën Zejtare në Therandë, por edhe në rajonin komunal, i kanë kryer fqinjët e Berishëve.

“Ky fakt nuk mund të fshihet. E dinë të gjithë se kush i ka udhëhequr krimet te ne”, thonë në familjen Berisha, dy vjet e gjysmë pas masakrës, kur edhe e vizituam këtë familje, duke ofruar argumente se emrat e tyre janë adresuar në instancat adekuate të përgjegjësisë penale.

Berishët, familjet e dy vëllezërve: Veselit dhe Faikut, të dy të vdekur gjatë luftës, kanë pësuar krimin më dramatik në Kosovë.

Vjollca, atë ditë korriku që e vizituam, nuk ishte në gjendje të fliste për tragjedinë që përjetoi në Therandë. Ajo nuk ishte në gjendje ta rikthejë memorien për ngjarjet në Qendrën Zejtare në Therandë, krim i përgatitur nga skenarët ruso-serb.

“Vjollca nuk ka forcë të tregojë ngjarjen...”, rrëfen zonja Adije

Berisha (1965), bashkëshortja e Xhelalit, derisa lotët i rrjedhin pa pushim, me lutjet “ta ruajmë Vjollcën që ka përjetuar shumë tmerre!”.

### SI FILLOI KRIMI MBI BERISHËT NË THERANDË?

“Në Therandë, krimi serb mbi shqiptarët e këtushëm ka filluar më 24 mars, ditën e bombardimit të NATO-s mbi caqet serbe”, nis rrëfimin Zonja Adije Berisha dhe vazhdon:

“Më 25 mars ka ardhur në derë policia serbe. Grupi prej gjashtë policësh ka pasur në duar dorëza të zeza. Dy prej tyre, e që flisin rusisht, përveç dorëzave, i kanë pasur të zeza edhe uniformat dhe ishte e qartë se ishin mercenarë.

Në orën 6 të mëngjesit të 25 marsit, policia është futur në shtëpinë e Faton Berishës së ndjerë, ku ishte me familjen e vet edhe Nexhat Berisha. Ka dal në derë gruaja e të ndjerit, Shyhretja, dhe u ka thënë policëve:

“Çka doni këtu?”.

“Kemi urdhër ta bastisim shtëpinë!”, thonë ata.

Por, pa e përfunduar mirë përgjigjen, e kanë shtyrë Shyhreten me forcë dhe janë futur brenda në shtëpi.

Në atë moment, Nexhati dhe Fatimja kanë provuar të zbresin poshtë shkallëve, duke parë se gjërat ishin acaruar dhe siguria ishte cenuar.

Policia serbe dhe rusët mercenarë iu vërsulen Nexhatit. Filluan ta grushtonin. E hodhën shkallëve nga kati i dytë. I kanë shkaktuar plagë e lëndime. Fatimes ia kanë plaçkitur pesëdhjetë mijë DM. Pasi i morën paratë, u thanë se për ju më nuk ka rrezik dhe mund ta vazhdoni jetën në shtëpi dhe të qëndroni pa brengë e frikë.

E dinim se plaçkitja dhe hajnia

ishin synimi kryesor i tyre në Kosovë, por, megjithatë, lëvizjet aq të theksuara serbe dhe paralizimi i jetës në Kosovë, nuk ishte rendi t’u besohej dhe të mashtroheshim.

Andaj, atë natë janë larguar nga shtëpia 25 anëtarët e familjes, duke kaluar në shtëpinë e Sedat Berishës (1954). Të gjithë, 25 anëtarët e familjes, e kanë kaluar natën te Sedati.

Por, drama më e rëndë ka filluar më 26 mars, në orën 12, në mesditë. Kanë ardhur numër i madh policësh dhe paramilitarësh, të cilët, përveç pranisë fizike, kanë përgatitur për sulm dy tanke.

Njëri tank është pozicionuar para e tjetri pas shtëpisë.

Ekspedita e policisë ka pasur me vete edhe shumë romë, rusë dhe tjerë shumë të gjatë, në mesin e të cilëve edhe fqinjët tanë, që i njihnim”.

### SI FILLOI EKZEKUTIMI I FAMILJES BERISHA?

Zonja Adije Berisha, e cila e vazhdoi rrëfimin pas disa çastesh, sjell në kujtesë dramën me ekzekutimet para shtëpisë në oborr...

“Zorani e ka ftuar Bujarin të dalë jashtë. Bujari ka dalë. Mes tyre është zhvilluar një bisedë. Janë fjalosur Bujari me Zoranin. Si rrjedhojë, Bujarin e mbajtën dhunshëm pranë vetes dhe të tjerëve u thanë të niseshin për në Shqipëri, menjëherë.

Të gjithë janë nisur në drejtim të stacionit të autobusëve. Vetëm Sedati është kthyer te policët. Brenga e tij ishte mbetja e vëllait, Bujarit, në mesin e policëve. Sedati i ka pyetur policët:

“Ku po ma çoni vëllanë?”.

“Meqë të intereson shumë, qëndro edhe ti këtu derisa ta kup-tosh se ku do të shkojë vëllai yt!”. Dhe, pas pak minutash, Bujarin



dhe Sedatin i kanë ekzekutuar para shtëpisë. Kanë mbetur të vrarë të dy në vend...

Nexhatin, Fatonin dhe Nexhmedin Berishën i kanë ndalur para shtëpisë së Fatonit. Fatimja ia ka ngjitur në grykë të automatikut policit, duke u munduar ta pengojë që të mos i vriste... Por, policët dhe paramilitarët i kanë vrarë, duke lënë të vdekur Nexhatin, Nexhmedinin, Fatonin dhe Fatimen.

Liria, pas pak, e ka bartur zvarrë të shoqin, Nexhmedinin, deri te Qendra Zejtare, duke shpresuar në ndihmë se ende kishte shenja jete. Me të ardhur në qendër, forcat serbe e kanë vrarë edhe Lirien dhe kanë shtënë përsëri në Nexhmedinin.

Pesëdhjetë vetë nga ky grup familjar dhe të tjerë, i kanë futur në Qendrën Zejtare të qytetit. Aty ka nisur një dramë tjetër tragjike e krimit mbi të ngjuarit në një lokal të kësaj qendre. I kanë mbyllur në atë lokal dhe u kanë hedhur bomba dore e predha të tjera eksplozuese, duke i vrarë ngadalë e nën mundime dhe duke i ekzekutuar në mënyrën që e kanë përdorur rusët nëpër zonat kaukaziane kundër myslimanëve. Në lokalin e Qendrës Zejtare në Therandë ka pasur edhe foshnja

tetë muajsh dhe fëmijë dy vjeç, që nuk janë përjashtuar nga vdekja makabre.

Të plagosurit vdisnin duke i parë të vrarët... Fëmijët qanin e bërtisnin, ndërkaq të plagosurit gjëmonin e rënkonin nga plagët...

Është rëndë të shpjegohet vdekja e Redonit të vogël, dyvjeçar... I kanë rënë rafal automatiku në bark...

Fatkeqësisht, të ngjuarit në lokalin e Qendrës Zejtare, fillimisht, i kanë gjuajtur me rafal automatiku. Si pasojë ka pasur shumë të vdekur e të plagosur... ", shpjegon e tronditur, Adija.

Dhe, pasi merr frymë thellë, vazhdon:

"Drama ka vazhduar një kohë të gjatë. Të ngjuarit, me siguri, do e kenë gjetur vdekjen shumë shpejt nëse nuk do jenë shtrirë mbi dysHEME...

Dhe, kur kanë pushuar britmat, janë ndalur të shtënat.

Në atë moment serbët dhe rusët e kanë hapur derën e lokalit dhe, kur i kanë parë njerëzit të shtrirë, e kanë sjellë kamionin "Zastava" me rimorkio të mbuluar me çadër, për t'i ngarkuar kufomat e për t'i dërguar në vendin që ata e kishin përgatitur enkas për të vrarët e kësaj masakre...

## TË GJALLËT DHE TË VDEKURIT I DËRGUAN NË VARREZA!

"Duke qenë të bindur se tashmë ishin vrarë të gjithë, serbët e udhëhequr nga fqinji ynë, e që e përmendëm më lart, sollën kamionin dhe nisën t'i ngarkonin kufomat.

Vjollca e Shyhretja kanë qenë gjallë, por të plagosura dhe ekzekutimit i kanë shpëtuar duke u bërë si të vdekura.

Paraprakisht Shyhretja e ka shpëtuar një kohë Eronin e vogël, i lindur më 1998, duke e mbajtur ndërmjet këmbëve, që të mos i binin copëzat e bombave që shpërndareshin në të gjitha anët, por më vonë edhe ai vdes.

Të vdekurit dhe të plagosurit, pastaj, i kanë ngarkuar në kamion, i cili është nisur në drejtim të Prizrenit. Kufomat kanë qenë të ngarkuara njëra mbi tjetrën!

Në ato çaste, Shyhretja dhe Vjollca, kanë ngritur kokën. Në turmën e kufomave ka lëvizur Gramozi (djali i Vjollcës). Ishte gjallë, por i plagosur.

Dhe, pasi kamioni është nisur në drejtim të Prizrenit, në një gjendje të rëndë psiko-fizike dhe pa asnjë shpresë se do të shpëtonim, e para ka kërcyer nga kamioni Shyhretja, e pas saj edhe Vjollca, e cila e ka marr me vete të birin, Gramozin.

Dhe, ato kanë pasur fat, sepse pas kamionit nuk ka pasur automjete tjera që do i merrnin me vete dhe do i vrisnin, pa dyshim.

Nga rrethi okular, i vetmi njeri, e që e ka parë ngjarjen tronditëse në lokalin e Qendrës Zejtare në Therandë, ka qenë Jashar Berisha, i cili është vrarë nga serbët po atë ditë në mbrëmje, në orën 17, në pompën e benzinës. Gardëroba e tij është gjetur te poligoni ushtarak i Lubizhdës së Prizrenit", thotë në fund të bisedës sonë, bashkëbiseduesja jonë, Adija.

**Safet Krivaça**



Me të ardhurit nga Turqia...



# Mirosala mbushet me nipër e stërnipër nga Turqia

*Të dielën, më 8 gusht, në odën e Nazmi Berishës në fshatin Mirosalë të Ferizajt, që sapo ka ardhur për pak ditë pushim nga Zvicra, katër kushërinjtë e tij, të ardhur nga Izmiri i Turqisë, po e shijonin me lot në sy vendlindjen e gjyshërve dhe Kosovën.*

Nevin Akbash, e lindur më 1954 në Turqi, ka qenë gjatë kësaj vere në fshatin Mazgit të Prishtinës, për të gjetur dikë nga familja

e nënë Maliqes, që i përket familjes Pllana, por nuk e gjeti askënd. Zonja Nevin ka shpresuar se do të gjente

dikë në vendlindjen e nënës së saj, në fshatin që mban Tyrben e Sulltan Muratit, të riparuar nga shteti turk para disa vjetësh.





## SI IKËN SHQIPTARËT E MAZGITIT NË VITIN 1912?

Zonja Nevin, me një shqipe që kuptohet mjaftueshëm, për historikun e familjes së saj, thotë:

“Nënë Maliqja ka jetuar 105 vjet. Ajo tregonte se si kanë ikur nga Mazgiti i rrethit të Prishtinës në vitin 1912, kur ishte në fund të fuqisë Perandoria Osmane. Tërheqja e ushtrisë turke ua mundësonte serbëve që t’u vërsuleshin shqiptarëve të Kosovës. Serbia do të fillonte masakrimin e shqiptarëve...”

Nënë Maliqja tregonte se e ka lënë tepsinë me mish pule e patate në zjarr dhe janë nisur për në Shkup, nën kërcënimin e Serbisë se do t’i masakronte shqiptarët. Së pari, kanë shkuar në Shkup, e prej aty në Greqi, ku kanë jetuar 3 vjet, pastaj kanë kaluar në Turqi, në qytetin Izmir”. Dhe, duke i përshkruar detajet, me nipin e saj, Rexhepin, i kombinojnë të dhënat historike rreth shpërnguljes për në Turqi. Thonë:

“Atë ditë nga shtëpia kanë dalë për në Shkup: gjyshja Duda, vjehrra e nënës, katër kunata dhe burrat. Janë detyruar ta lëshojnë shtëpinë sa më shpejt, sepse do të masakroheshin nga Serbia”, thotë zonja

Nevin.

Nënë Maliqja u ka treguar fëmijëve të vet edhe kohën sa kanë jetuar në Greqi, në pritje për të shkuar në Turqi.

Dhe, lidhur me këtë udhëtim, u ka thënë se qëllimi i tyre nuk ishte Turqia, por Siria. Anija në të cilën ndodheshin ata ishte prishur në Greqi dhe aty kanë mbetur tre vjet.

Edhe Murati, babagjyshi i të cilit, Osmani, është shpërngulur në Turqi më 1930, thotë se ka qenë vështirë të jetohej në Turqi. Atje shteti nuk jepte ndihma, pos që ua mohonte mbiemrat dhe trashëgiminë familjare e kombëtare, duke u dhënë mbiemra siç donin ata vetë...

“Mbiemri i babës ka qenë Dedia. Në Turqi i kanë regjistruar me mbiemrin Akbash, që në turqisht do të thotë çel (pa flokë). Kjo të jep të kuptosh se edhe në Turqi kanë vuajtur shumë...”, thotë Murati.


## SI I DËRGUAN TURQIT SHQIPTARËT NË LUFTË?

Ata mezi kanë mbijetuar në Turqi, duke lënë edhe jetimë të vegjël, pasi kryefamiljarët Hajdar Akbash (Dedija) dhe Rustem Akbash (Pllana), u morën detyrimisht nga shteti turk për t’i rekrutuar në luftën e Canakalasë, prej nga nuk u kthyen kurrë më dhe nuk u dihen as varret.

Lufta e Canakalasë, që njihet në historinë e të gjitha betejave botërore si lufta më vdekjeprurëse, ka ndodhur më 1915, në ngushticën e Canakalasë. Forcat britanike dhe ato franceze kishin bërë flotën e përbashkët për ta sulmuar Turqinë, me qëllim që ta nxirnin nga ndikimi i Luftës së Parë Botërore. Mirëpo, flota detare turke e fitoi betejën, duke i shkuar Britanisë dhe Francës humbje të rënda në ushtri dhe anije luftarake.

Turqia e fitoi betejën e Canakalasë, pas së cilës u shpëtua pushtimi i Stambollit, por nami i fitores mori dhenë me pjesëmarrjen masive të shqiptarëve në këtë luftë, që nuk e lëshuan frontin deri në fitoren definitive.

Ndonëse Turqia nuk i lartësoi figurat e shqiptarëve në betejën e Canakalasë, e që fitoren, kryesisht, e sollën shqiptarët, duke



treguar trimëri të lartë, familja Dedija dhe Pllana, nipërit e të cilëve tani e vizitojnë Kosovën, në atë luftë kanë humbur Hajdarin dhe Rustemin.

“Si pasojë e asaj lufte, në shtëpi kanë mbetur dy vëllezër jetimë: Rexhepi e Orhani, njëri 5 e tjetri 6 vjeç.

Ata çdo ditë qanin te dera e shtëpisë, në sokak, sepse edhe nëna u kishte vdekur po ato ditë. Dhe, fati deshi e një ditë, teksa qanin, i sheh një pasanik turk, Ali Aga. I pyet pse qajnë...

“Jemi jetimë, pa babë e nënë”, thonë ata. Dhe, Ali Aga i merr në shtëpi Rexhepin dhe Orhanin. Kur i pari i ka mbushur 19 vjet e i dyti 18, kanë shkuar ushtarë. E, pas kryerjes së ushtrisë Ali Aga u ka dhënë pasuri nga pasuria e vet”, thotë zonja Nevin. Andaj, falë Ali Agës, familjet e tyre, edhe pas më shumë se 100 vjetësh, mbajnë miqësi e afërsi dhe i janë gjithmonë mirënjohës kësaj familje humanitare.

## NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Sot në Turqi jetojnë disa milionë shqiptarë. Thuhet se janë mbi 10 milionë. Por, shifra nuk është e saktë, meqë shteti turk nuk i regjistron banorët sipas përkatësisë së tyre kombëtare, por i regjistron turq. Mirëpo, me rëndësi është se ata e ndjejnë veten shqiptarë dhe interesohen për vendlindjen e gjyshërve e baballarëve të tyre.

Rasti i këtyre ditëve, në Miroslalë të Ferizajt, flet më së miri se sa janë të interesuar shqiptarët e Turqisë për vendlindjen e të parëve të tyre...

**Safet Krivaça**



*Ku, si, çka...*

# Ku ndodhet mbesa

## *e Nexhmije Pagarushës, Bleta Mulliqi?*



*Me sy të mëdhenj e shumë shprehës, me një shqipe me aksent evropian, Bleta Mulliqi para disa vjetësh ishte në faqet e “Kosovares”.*

*Shtrohet pyetja: Ku ndodhet tash mbesa e Nexhmije Pagarushës dhe e Rexho Mulliqit?*

Ishe shumë e vogël kur në Prishtinë i filloi mësimet në shkollën për piano. Dhe, duke qenë mbesë e këngëtares sonë shumë të njohur, Nexhmije Pagarushës, si dhe e kompozitorit, Rexho Mulliqit, vajzës së re, Bletës, i lindi pasioni për këngën.

Ishte pjesëmarrëse në “Ethet e së premtes mbrëma” (2001-2002), ku arriti deri në gjysmëfinale.

Bleta e ka kryer shkollën e mesme të muzikës “Prenk Jakova” në instrumentin kanto-violinë, si dhe Shkollën e Baletit. Startoi në Festivalin “Shou Fest 2003”, me këngë të Ilir Beranit. Në vitin 2008 publikoi videoklipin “Dance Avec Moi” dhe kënga fitoi një çmim në Festivalin “Mikrofoni i Artë 2008”.


Bleta ishte pjesëmarrëse e shumë festivaleve: “Polifest”, “Videofest”, “Nota Fest” dhe në Maqedoni ka fituar shumë çmime.

Bleta prej vitesh jeton në Zvicër dhe atje i ka kryer studimet për UBT.

Dhe, përveç këngës, Bleta Mulliqi pasion e ka edhe vallëzimin. Sepse, vallëzimi e ka ndihmuar edhe në skenë që të jetë sa më e lirë, sa më e natyrshme...

**D.**





**Mandarine Restaurant by Marina Bay**  
+35533410000  
+355696041000

**Lime Lounge by Marina Bay**  
+355696041001  
info@marinabay.al  
www.marinabay.al

**Adresa:** Vlorë, Shqipëri

# Hallën e thërret nënë, sepse ajo e rriti

*Vetëm disa mure ndajnë shtëpinë time nga shtëpia e fqinjës sime. Një grua e shkurtër me trup, por e madhe në zemër. Të gjithë e njohin si grua të sjellshme, të ndershme, të singertë që argëton me batuta të saj, por edhe si grua mjaft të përvuajtur që jeta e sprovoi shumë.*

Gruaja këmbëshkurtër, fytyrërrumubullake e pak e trashë, është fqinja ime, e cila më pret gjithmonë me ngrohtësi e dashuri, sa herë që e vizitoj.

Hallet, brengat, mërzitë e padrejtësitë që ia sjellë jeta mundohet t'i fshehë me një buzëqeshje në fytyrë e për këtë gjë të gjithë e lakmojnë.

Flokët e zezë, paksa të thinjur, vetullat e trasha të ulura, rrudhat tek sytë e kaftë, të

bëra nga vuajtjet e jetës, e bëjnë të duket edhe më e vjetër se që është.

E veshur me një fund të kaftë dhe xhakëtë të zezë, që duket e mbyllur nga jashtë, ka një forcë e vullnet të madh brenda.

Edhe pse jo mirë ekonomikisht e me shëndet të ligë, Zoti e begatoi me një familje të madhe, por e sprovoi me vëllanë e saj me aftësi të kufizuara, për të cilin ajo tregon me lot në sy, pas një vizite që ia bëra disa ditë më parë.

## NUK E HARROI ZOTI, POR...

Edhe pse i tillë, ai, megjithatë, e gjeti fatin e jetës nga e njëjta kategori dhe u martua. Çifti u bekua pas një viti me fëmijën e tyre të parë, me një djalë të shëndoshë, e pas 7 viteve edhe me një vajzë të bukur.

Por, gjërat nuk vazhduan të shkojnë mirë, shëndeti i gruas së tij u keqësua dhe dy muaj pas lindjes së vajzës së tyre ajo vdiq, duke i lënë fëmijët në duart e një babai që nuk ishte në gjendje të kujdesej për ta.

Pas vdekjes së nuses, familja e saj i merr fëmijët në përkujdesje, duke mos lejuar babanë as t'i përqafojë!

E, si mund të jetojë një baba pa fëmijët e tij? Rasti u paraqit edhe në polici dhe më pas fëmijët iu dorëzuan babait.

Djali ishte 7 vjeç e vajza vetëm 6 muajsh, andaj babai i tyre nuk ishte në gjendje të kujdesej për ta, sepse nuk ishte në gjendje

të kujdesej as për vetveten.

Fëmijët i mori t'i rriste motra e tij, pra fqinja ime. Ajo u përkrah shumë nga burri e nga fëmijët e saj. Edhe pse jo mirë materialisht e me shëndet, ajo i bëri një premtim vëllait të saj invalid: "O vëllai im, në këmbë e duar do të ec e fëmijët do i rris. Do kujdesem për ta si për fëmijët e mi", tregon fqinja.

"Burri im ka qenë mbështetja ime më e madhe, ai edhe më ka ndihmuar të kujdesem për ta. Por, edhe ai vdiq. Gjëja e fundit që ai bëri ishte ledhatimi i nipit tim para se të flinte", tha ajo.

## NË VEND SE HALLË E THËRRISTE NËNË!

Ajo në vazhdim më tregoi për dhimbjen e madhe që ka ndjerë kur vajza e vogël, para se t'i mbushte dy vjet, kishte filluar t'i thoshte fjalët e para. E thirri me emrin nënë. Sepse, këtë fjalë e mësoi nga vajzat e vërteta të saj teksa e thërrisin ashtu. Dhe, edhe tash e thërret po me të njëjtin emër, ani pse e di se nuk është nëna e saj e vërtetë. Të vërtetën se ajo nuk është nëna e saj ia tregoi gjyshja, pasi halla nuk arriti dot t'ia thoshte se nënën nuk e kishte gjallë. Edhe vajzat e saj i thërret motra, sepse për të kjo është familja e saj... Ata janë rritur tashmë. Djali jeton me babanë, madje edhe kujdeset për të...

Xh. A.



Modele: Simoneta Bajrami

# BOOM

Simoneta  
Bajrami

*nuse madhështore*

Rifat Osmani,  
dentisti shqiptar që bën  
revolucion në Zvicër

Shqiptarët  
që na e zbardhin  
fytyrën në botë

Rifat Osmani është dentisti i njohur shqiptar në Zvicër, që po bënë revolucion me teknikat e reja dhe inovative për rregullimin e dhëmbëve. Ai ka klinikë tejet të dixhitalizuar, me pajisje moderne e të sofistikuara, e cila quhet "Zahnarztosmani". Ai e do shumë profesionin e tij dhe kjo duket edhe në postimet në rrjete sociale. Djaloshi nga Gostivari, e që u rrit në Zvicër, është model i shkëlqyer i integritetit dhe arritjes në një nga vendet më delikate në Evropë. Stomatologu ka fituar besimin e mijëra pacientëve, të cilët ndihen të sigurt dhe komod falë profesionalizmit të lartë që ai posedon. Me mjekun e aftë, të dhënë në basketboll dhe njeriun që shëtit botën, flasim në "Kosovare"...



## Rifat Osmani, dentisti shqiptar që bënë revolucion në Zvicër

### Kush është Rifat Osmani?

- Jam 36-vjeçar, nga Gostivari, jetoj dhe veproj në Zvicër. Jam mjek dentist, baba i dy djemve dhe shumë i apasionuar në basketboll. Më pëlqejnë udhëtimet dhe e vizitoj gjithë botën.

### Pse vendosët të studioni për dentist dhe ku i përfunduat studimet?

- Gjithmonë kam pëlqyer biologjinë, por më ka interesuar edhe mirëqenia e njeriut. Si fëmijë kam qenë shumë kurioz dhe nuk kam lënë asgjë nga teknika pa e hapur. Krejt kjo përbënte një kombinim perfekt për t'u bërë dentist. Studiova në Bazel dhe isha një nga më të mirët.

### A ishte rrugë e gjatë dhe sfiduese ajo e studimeve dhe specializimit?

- Në Zvicër është mjaft rëndë, pasi ka pak vende për dentist. Duhet t'i nënshtrohesh një testi mjaft të vështirë. Shumë mërgimtarë të gjeneratës sime nuk ia kanë dalë edhe për shkak se nuk kanë pasur ndihmë nga familja, pastaj se nuk e dinin gjuhën mirë etj. Mendoj se me shumë punë dhe disiplinë, i dilet më së miri. Si unë, edhe shumë shqiptarë të tjerë, ia kanë dalë në rrugën e suksesit në Zvicër.

### Kemi dëgjuar se keni diplomuar me notë shumë të lartë. Çka të motivonte për t'iu dedikuar aq shumë studimeve?

- Kur nisi një punë, atëherë e bëjë maksimumin. Këtë shans që e kisha në dorë, nuk mund ta lija t'më ikte. Prindërit e mi i kanë financuar studimet e mia, andaj doja që t'ua shpërbleja me nota të mira.

Puna praktike e çdoditshme dhe motivimi, më kanë bërë akoma më të mirë...

### A e kishe projektuar të ardhmen, a dije se një ditë do të ishe ky që je sot?

- Përherë kam qenë nxënës i mirë, kështu që e dija se do të studioj. Si fëmijë dhe adoleshent kam kaluar





shumë kohë para kompjuterit, andaj mendoja se do të studioja informatikën.

Kam qenë i mbyllur dhe nuk kam komunikuar shumë. Nuk e di nëse kam menduar ndonjëherë se do të jem ky që jam sot...

### **Fillimisht keni punuar për një klinikë, apo?**

- Po, tre vitet e parë punova në "Zahnarztzentrum" në Will. Përfitova shumë dije, e përmirësova punën time praktike. Aty kishim raste urgjente dhe kjo më dha shkollë të re në profesionin tim.

### **Tashmë keni klinikën tuaj dentare. Ku gjendet dhe cilat janë shërbimet që ofroni?**

- Prej vitit 2014 jam në Bütschwil Sg. Në fillim të këtij viti e hapa edhe klinikën e dytë, në Ebnat Kappel sg, në Toggenburg, afër Willit. Ndryshe, unë jam dentist i përgjithshëm, por më shumë më intereson protetika, endotologjia dhe orthopedia. Në klinikën time jemi tre dentistë dhe një kirurg. Gjithashtu, jam zgjedhur si dentist për shkollë dhe kemi shumë pacientë shkollarë, ku i trajtojmë edhe në mënyrë argëtuese, që ata të mos kenë frikë dhe të vijnë me dëshirë në klinikë.

### **Kontrolloni mijëra fëmijë. Si keni arritur ta fitoni besimin e tyre?**

- Fëmijët më kanë dashur gjithmonë, se me fëmijën duhet të bëhesh fëmijë. Unë bëj shumë video në tik-tok, e që janë qesharake. Më pyesin se a mund të bëjnë edhe ata një video me mua. Kështu, e harrojnë frikën. Me fëmijët duhet të flasësh dhe t'u japësh mundësinë që ta fitojnë besimin. Njëjtë veproj edhe me të rriturit që kanë frikë.

### **Keni më shumë pacientë shqiptarë apo të nacionaliteteve të tjera?**

- Jam i gëzuar që viteve të fundit kanë nisur të vijnë edhe shumë shqiptarë. Përpara shkonin më tepër në vendlindje për t'i rregulluar dhëmbët. Megjithatë, ende 70 për qind e pacientëve i kemi zviceranë.

### **Je nga Gostivari, por jeton dhe vepron në zemër të Evropës dhe duket se jeni integruar mirë, apo jo?**

- Kurrë nuk e harroj vendlindjen. Jemi njerëz temperament dhe të zjarrtë. Vetë emri i klinikës "Zahnarztosmani", tregon se jam krenar prej nga vij. Por, pasi e flasë gjuhën në mënyrë perfekte, kam kryer ushtrinë këtu dhe jam shumë mirë i integruar, ma bën më të lehtë dhe jo me shumë sfida punën në këtë vend. Gjithsesi, zviceranët janë popull lojalë dhe nuk u intereson shumë nga vjen, por çfarë bënë dhe a je i mirë në atë që bënë.

### **Në klinikën tuaj punohet me teknikat më të reja e të avancuara. Ju lutem, na tregoni pak më shumë për këto inovacione në "Zahnarztosmani"?**

- Qe dy vjet punoj komplet në mënyrë dixhitale. Masat i marr vetëm me scan etj. Punoj me invisalign për ortodontikë. Shkoj në shumë kurse dhe provoj inovacione të reja, si, për shembull, protezën e bërë komplet në kompjuter etj.

### **Çfarë mendoni për punën stomatologjike dhe dentare që bëhet në trojet shqiptare?**

- Kam parë punë të mirë, veçanërisht në protetikë, ku kam shumë eksperiencë. Por, vërehet që pu-

nojnë nën stres në kohën e pushimeve, pasi lëshojnë disa gabime ose bëjnë më shumë se që ka nevojë. Në endotologji dhe paradontologji ka mjaft për t'u përmirësuar.

### **Gjatë punës suaj profesionale, ka ndonjë rast interesant që u ka ndodhur?**

- Po, shumë raste, si, për shembull, një fëmijë 10 vjeç ka qenë i çuditshëm, pasi ka qeshur gjatë gjithë kohës, nuk kishte frikë... Gjithashtu, një gruaje, moshatare, ia hoqa dy dhëmbë pa anestezion dhe nuk lëvizi fare! Më tha që ka lindur 10 fëmijë. U habita.

### **Ju jeni mjaft aktiv edhe në rrjete sociale dhe videot tuaja në Tik-Tok janë fantastike. Nga u lindin idetë?**

- Është një mundësi e shkëlqyer që përmes këtyre videove ta shohin dentistin në një version tjetër. Gjërat që njerëzit i kanë shumë frikë, i kombinoj me humor. Shumë video janë spontane, por e kam edhe ekipin tejet të mirë dhe më japin impute. Edhe vetë pacientët dhe ndjekësit më japin ide të ndryshme.

### **Cila është jeta juaj private?**

- Ajo që e bëj mjaft mirë është se jetën private di ta ndajë mirë nga jeta profesionale. Jam i martuar, kam dy djem dhe një vëlla dhe jam shumë i lidhur me prindërit.

### **Mesazhi juaj?**

- Dhëmbët janë shumë të vlefshëm. Duhet ta dini që shumë sëmundje fillojnë nga goja dhe për këtë arsye kushtoni më tepër kujdes higjienës orale. Pastaj, të gjithë duan një buzëqeshje të bukur...

**Nderim Neziri**  
**Foto: Armend Berisha**



#zahnarztosmani.ch

**Terminet mund të bëhen edhe online**

Janë 9 punetore që kujdesen për shëndetin e dhëmbëve tuaj. Dy dentistë, një kirurg dhe stafi tjetër shoqëruar. Kushdo që ka nevojë për kontrollim apo mjekim të dhëmbëve, mund ta kontaktojë ordinancën stomatologjike online <https://zahnarztosmani.ch> ose përmes adresës:

**Zahnarzt Osmani**  
Ottilienstrasse 16 • 9606 Bütschwil  
Tel: +41 71 983 20 33







# Simoneta Bajrami, nuse madhështore

*Simoneta Bajrami është emër i njohur i fushës së bukurisë dhe estetikës medicinale. Puna dhe klinika e saj estetike “Dermo by Simoneta” në Ferizaj, janë tejet të njohura kudo.*

*Simoneta ia ka dalë që me profesionalizëm dhe përkushtim ta bëjë emrin e saj të njohur ndër njerëz. Dihet që një numër i konsiderueshëm i fytyrave publike janë kliente të rregullta të Simonetës...*

## E TALENTUAR, E SHKOLLUAR, PROFESIONISTE, E PASHME

Këto janë vetëm disa nga cilësitë e ferizajases, e cila ndiqet shumë edhe në rrjete sociale, ku prezanton punën dhe arritjet e saj, por edhe pjesë nga jeta dhe përditshmëria.

Stili i Simonetës është i adhureshëm, andaj shumë vajza fiksohen në pamjen, veshjet, aksesorët dhe kombinimet që bëjnë. Simoneta shpesh në “Instagram” bënë sesione me pyetje dhe përgjigje. Interesimi i ndjekësve për të ditur më tepër për të është i madh.

Ka nga ta që interesohen

edhe për jetën e saj private dhe detajet më personale. Ndryshe, Simoneta njihet edhe si vajza e këngëtares së mirënjohur, Antigona Sejdiu, e cila i është rikthyer sërish muzikës dhe po e bënë më të mirën.

## BUKUROSHJA FERIZAJASE

### I JEP FUND BEQARISË

Pas dhjetë vjetësh në lidhje dashurie, çifti Simoneta Bajrami e Ardian Izeti, i dhanë fund beqarisë. Nuk kaloi pa vëmendje media-tike as kanagjegji i Simonetës me shumë të ftuara, ku këndoi mikja e saj, Fifi, ndërkohë që atmosferën e ka ndezur e ëma e bukuroshes, këngëtarja e afir-

muar, Antigona Sejdiu, e cila me emocione ka interpretuar dhe prekur zemrat e të ftuarave.

Çifti kishin planifikuar dy ceremoni: njëren që e bënë në jug të Shqipërisë me shoqëri; e dyta, më madhështorja, me familjen e gjerë në Ferizaj.

Në dasmën që do të mbahet në mend gjatë, kënduan: Fifi, Fidan Ahmeti dhe Antigona Sejdiu, e ëma e Simonetës, e cila i dha nuses së re një ndjenjë tejet të veçantë, më të bukurën në botë.

Çifti e shijuan pafund dasmën dhe ata nuk u ndalën për asnjë moment duke vallëzuar...

**Drenushë Hajredinaj**

# Shqiptarët që na e zbardhin fytyrën në botë

*Vijnë nga toka e shqipeve, kanë fluturuar lart, por sytë i kanë në vendin e tyre. Janë shqiptarët e mëdhenj e të suksesshëm, që kurrë nuk e mohuan origjinën dhe u bënë ambasadorët më të mirë të trojeve shqiptare...*



## EMINE ÇUNMULAJ

Shqiptarja që ka ecur në pasarellet më të mëdha për kreatorët më të famshëm. Ka dalë edhe në kopertinën "Vouge". Ani pse nuk është martuar me shqiptar, është tejet tradicionale.

## INVA MULA

Soprano e jashtëzakonshme me pjesëmarrje në skenat më të mëdha të operës në botë. Grua zonjë që na ka nderuar kudo...



## FADIL BERISHA

Është dera e artistëve shqiptarë në Nju-Jork. A ka shqiptar që ka bërë më shumë për afirmimin e racës sonë të bukur?



## RITA ORA

E madhe me plot kuptimin e fjalës. Ajo mund të flasë në cilën gjuhë të dojë, por zemra i flet shqip. Së fundi, po bënë nam në "The Voice" në Australi.





## LORIK CANA

Sukseset e tij në arenën e futbollit njihen, dihen. Është rritur larg Kosovës, me atdasheduri të jashtëzakonshme për vendlindjen.

Cana, si Kapiten i Kombëtares Shqiptare, ka synuar unifikimin dhe është bërë simbol bashkimi.



## LUAN KRASNIQI

Kampion i shumëfishtë, që mbrojti ngjyrat e Gjermanisë. Edhe në kohët më të vështira për Kosovën, arriti të depërtonte e të bëhej krenaria jonë.



## GRANIT XHAKA

E vlen ta shohësh në fushë dhe e kupton se është shqiptar. E lë zemrën aty. Kur Graniti e bënë shqiponjën me duar, zemrat tona qohen peshë.

Është djalë i emocioneve të forta futbollistike. Është shqiptar tradicional.



## XHERDAN SHAQIRI

I përshtatet shumë emri xherdan. Sukseset e tij në futboll janë të pakrahasueshme. Ka qenë tejet i diskutuar vendimi i tij për të mos luajtur për Kosovën, por është për t'u admiruar fakti se ai nuk e mohan origjinën, e bënë shqiponjën me duar kudo dhe dëshiron të martohet vetëm me shqiptare.



## DUA LIPA

Gramy-t, çmimet e tjera, albumet më të shitura, e kanë larë në ar këngëtaren Dua Lipa, që është bërë gjysma e zemrës së shqiptarëve.

Një shqiptare krenare dhe Ambasadore e kombit të vet si ajo...

# Cila nënë e dhunuar e mbyti foshnjën e porsalindur?

*Kur nëna vret fëmijën, është e qartë se fryti është i padëshiruar dhe i urryer. Është evidencuar rasti i parë i këtyre pasojave. Por, çfarë shkalle e lindjeve të kësaj natyre ka ndodhur në Kosovë, mbetet enigmë, meqë femrat e dhunuara në Kosovë, e që sipas statistikave janë rreth 22 mijë, ende nuk kanë folur për ndodhinë e tyre, me ndonjë përjashtim të vogël...*

Sindromi i urrejtjes së frytit të porsalindur, e që vjen nga dhunimi, ka filluar t'i ndjejë pasojat në Kosovë. Një nënë e re, në muajin mars të vitit 2000, e ka mbytur foshnjën e vet, posa ia kanë dhënë në dorë infermieret.

Nëna e re, posa e mori foshnjën në krahë, ia drodhi kokën, duke e shuar jetën e saj. Pas krimit ka pasuar marrja në pyetje e nënës dhe deklaratat e saj rreth veprës kriminale...

Më pas u mësua se foshnja e porsalindur ishte produkt i aktit seksual të dhunimit, që kishte ndodhur më 1999, gjatë spastrimit etnik të shqiptarëve nga Kosova.

Megjithatë, veprimi i tillë është vepër penale - vrasje dhe për këtë prindi përgjigjet penalisht para drejtësisë së shtetit.

Diç e tillë ka ndodhur edhe me gratë boshnjake të dhunuara në luftën e Bosnjës. Gratë myslimane nga këto dhunime, duke mos pasur ku të abortojnë, kanë lindur nëpër spitalet e Kroacisë. Dhe, sipas statistikave zyrtare, 100 mijë gra myslimane kanë lindur fëmijë nga procesi i dhunimeve serbe.

Ndërsa, ato nëna që nuk kanë pasur fuqi ta ekzekutojnë frytin e vet, foshnjat e tyre i kanë lënë nëpër spitale, duke i braktisur apo duke i lënë edhe nëpër jetimore dhe në institucione të tjera humanitare.

## PSE NUK FLASIN TË DHUNUARAT?

Dy arsye janë thelbësore, që janë pengesë për publikimin e të dhënave mbi dhunimet:

Një, se zyrtarët hezitojnë të flasin me argumente që i njohin dhe janë të ditura shumë, meqë dihet numri i femrave të dhunuara në Kosovë.

Dhe, dy, hezitimi i të dhunuarave që të flasin haptazi, si botëkuptim konservativ. Sepse, secila e dhunuar, në një shoqëri patriarkale si e jona, shihet me sy jo të mirë nga rrethi, edhe pse dihet se dhunimi bëhet me presion, sulm dhe jashtë çdo dëshire.

Njohësit e rrethanave nga këto dukuri konsiderojnë se tek pas disa vjetësh të dhunuarat do të mund ta qelin gojën, për të dhënë rezultatet e para të tragjedisë personale, por që bëjnë një kolektivitet të plotë.

Fakti se një grua, e cila ka mbytur foshnjën e vet pas lindjes dhe që dihet me emër e



mbiemër, e që u mor në pyetje dhe mbajtje për disa muaj në burg, dëshmon se të tilla raste ka mjaft.

Grumbullimi i fakteve ka rëndësi të veçantë, sepse mund të ndihmojnë në zbardhjen e kësaj të keqe në Hagë kundër Serbisë, e cila lëre më që zhvilloi luftë të ndyrë, por edhe dhunoi gra e vajza shqiptare sa herë që patën rastin... E, ajo që dihet është se në vitin 2001, kur edhe është bërë ky shkrim, një numër grash të dhunuara po trajtoheshin në Itali. Ato trajtohen, por nuk flasin!

Ka fakte se rreth 100 femra, në një fshat ndërmjet Prishtinës e Podujevës, kanë pësuar dhunim nga serbët më 22 e 23 prill të vitit 1999. Të gjitha janë parë të jenë zbarkuar nga një automjet i tipit "TAM", në një fshat të rrafshit, 18 kilometra në jug të Prishtinës, në magjistralen Prishtinë-Ferizaj.

## Ç'THONË GJINEKOLOGËT PËR KËTË TRAGJEDI KOLEKTIVE?

Institucionalisht, një zyrat i spitalit gjinekologjik në Prishtinë, atëbotë i tha revistës "Kosovarja" se do të del publikisht me një kumtesë rreth këtyre problemeve. Ai tha se kishte edhe dezinformata dhe ishte tepër e nevojshme të sqarohen gjërat, në mënyrë që të flakeshin të pavërtetat... Megjithatë, ndjeshmëria tematike e bëri të veten dhe askush kurrë nuk doli zyrtarisht të thotë të vërtetën, edhe pse Tribunali i Hagës garantonte ndjekje penale për ata që ishin identifikuar si dhunues nga pala e dëmtuar.

## Ç'THONË TË ANKETUARIT PËR DHUNIMET?

Merita, 26 vjeçe, studente nga Prishtina, thotë se mediet duhet t'i kushtojnë hapësirë më të madhe temës së dhunimeve. Ajo shprehë bindjen se tashtëm dihet se ka

shumë të dhunuara në Kosovë dhe burrat duhet të tregohen tolerantë ndaj femrave të dhunuara.

Është shumë e dobishme që femrat e dhunuara të flasin dhe ta kurajojnë njëra-tjetrën se duhet të flitet për këtë temë dhe se askush tjetër nuk mund ta përçojë zërin e dhimbjes më mirë se ato që janë dhunuar... Ajo sjellë kujtimet nga kampi i Stankovecit në Maqedoni, ku ka folur me disa femra të dhunuara.

"Kam qenë banore e kampeve në Maqedoni. Gjatë tre muajve, sa kam qëndruar atje, kam pasur rastin të dëgjoj shumë rrëfime të tmerrshme nga të dhunuarat që i mbanin në vete përjetimet e tmerrshme. Përveç dhunimeve, kam pasur rastin të dëgjoj edhe për disa vrasje të femrave që kanë ndodhur pas dhunimit të tyre. Pse kanë ndodhur ato?

Kur dhunuesi ka qenë fqinji i saj, ai e ka kryer vrasjen, në mënyrë që ta shmangë mundësinë e denoncimit. Kjo është dhembje që ta kallë shpirtin, andaj gazetat, intelektualët dhe historianët, duhet ta shpërndajnë gjithkrah faktografinë e dhunimeve në Kosovë", thotë Merita.

Në anën tjetër, Nadirja, 31 vjeçe, infermiere, e di saktësisht se ka të dhunuara në Kosovë.

"Është e tmerrshme ajo që po flitet në popull se nuk ka pasur dhunime gjatë luftës në Kosovë...

Në anën tjetër, më lëndon fakti se disa femra të dhunuara janë detyruar të kërkojnë falje nga bashkëshortët! Si femër që jam, më duket ligësi morale t'i kërkojë falje gruaja burrit se është dhunuar me dhunë nga serbët...

Kam dëgjuar se disa femra të dhunuara kanë bërë vetëvrasje, vetëm e vetëm që të mos përgojohen...", thotë Nadirja. Sidoqoftë, dhunime të femrave në Kosovë gjatë luftës ka pasur, madje shumë. Dhe, herë do kur femrat e dhunuara do të flasin, do të tregojnë përjetimet e tyre të hidhura. E, kur do të ndodhë kjo, pritët të shihet...

**Sokol Murturi**

## Budallallëku nuk ka fund...



## Në cilin qytet shqiptar, po nuk i pate 250 mijë euro, mbetesh pa martuar?!

Dasmat shqiptare kushtojnë shumë, sidomos ata që organizojnë dasma tradicionale. Vetëm veshjet e nuseve në Kërçovë kushtojnë mijëra euro, deri në 250 mijë!

Për të marrë një nuse nga Kërçova e Maqedonisë, dhëndri i ardhshëm duhet të ketë 5 mijë euro për një fustan sipas traditave shqiptare.

E, po ta shikosh në përgjithësi, atij i duhen 250 mijë euro për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet që kërkojnë nga familja e vajzës!

Gjësendet e arit që vendos nusja ditën e dasmës, zakonisht kanë çmime nga 1 mijë deri në 5 mijë euro.

"Kur kërkon nuse në Kërçovë, nëse nuk je i zoti ta veshësh nusen në dylyma ari 250 mijë euro, atëherë nusen nuk ta japin.", është shprehur Elton Mehaj, pjesëmarrës në një dasmë atje.

Qesharake, se jo mahi!

# Pse nuk jam e lumtur si të tjerët?

*Sot mora guximin të shpalos këtë zemër timen, e që ka kohë që vuan. T'i shpalos plagët e mia, e që sa kohë mendojnë brendinë e shpirtit tim. Në zemrën time të mërzitur ka shumë vuajtje. Por, me vuajtje ka edhe gjëra të cilat më mbanin gjallë se një ditë do të bëhet mirë, një ditë edhe unë do të jem si të tjerët: e buzëqeshur, e lumtur...*

Shpesh e pyes veten: Pse nuk jam edhe unë e lumtur si të tjerët? Pse nuk buzëqesh edhe te unë fati? Apo, ndoshta e kam ngase e mallkoj veten për shumë gjëra që ma lëndojnë shpirtin e nuk më lënë rehat. Ndoshta edhe Allahu ka të drejtë që sillet kështu me mua, si të jem e verbër. Dua të shkruaj gjërat që unë i mbaj në zemër se nuk dua këto të humbasin, edhe nëse unë do të humbi, të paktën, të tjerët ta dinë brendinë e zemrës sime.

## A DO TË BËHET MIRË EDHE PËR MUA?

Ah, kjo zemër imja duroi shumëçka, mbajti shumëçka si kujtime. Nganjëherë më duket se kjo jetë është vetëm kalimtare e asgjë më shumë, nganjëherë i humbi

shpresat mbase se humbi edhe vetë me gjithë to. Jam e lodhur nga mendimet, nga pyetjet që ia bëj vetes.

A thua, një ditë, a do të bëhet mirë edhe për mua? Por, përgjigje nga askush nuk marr. Nganjëherë, kur shpalosi zemrën, aty je edhe ti, je bashkë me plagët e mia, je në brendinë e zemrës sime, që deri në vdekje nuk do të kesh largim.

Ah, kur mendja më rri te ti, krejt e harroj veten, më duket se çdo gjë shkon për së miri, çdo gjë është në dukurinë e vet. Por, kur e mendoj se ku je ti e ku jam unë, atëherë je larg, shumë larg.

Ah, them me vete, pastaj, asgjë nuk qenka kjo botë e pislavët, vërtet, botë me gënjeshtër.

Nganjëherë zhytem thellë në mendime, duke menduar për ty, kurse e harroj

veten time, duke zhgënjyer veten, duke menduar se një ditë do të jemi afër, shumë afër njëri-tjetrit, aty ku çdo herë e kam ëndërruar të jemi së bashku.

Por, ja që jeta qenka e kotë. Thotë një fjalë popullore: "Shpresa vdes e fundit", ndërsa mua më duket se shpresa më ka vdekur para se të vdisja unë.

## MË E MËRZITUR SE KURRË...

Sot jam diç më e mërzitur se ditëve të tjera dhe nuk di as vetë pse...

Nga lodhja, duke shpresuar, apo nga dhembjet që kam në shpirt? Apo nga pritjet se një ditë edhe për mua do të jetë mirë, si për të gjithë të tjerët.

D. H.





**PARA**

**PAS**



**20 SEANCA**

**-13 KG**

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.



# ***Pse Kryeministri flet vetëm për suksese e jo edhe për dashuri?***

*Sa herë që i pari i Qeverisë flet për suksese, numri i të infektuarve me Covid-19 në Kosovë dukshëm rritet...*

Filmat orientalë po shikohen në Kosovë me të madhe dhe televizorët e kanë gjetur veten në këtë

“mision” shikueshmërie. Dhe, po të mos ishin filmat e tillë, televizorët tona nuk do të shikoheshin në

masën sa shikohen tash. Gruaja ime i shikon serialat turke. Një ditë, teksa po e shikonte njërin



prej tyre, në kohën kur luhej një ndeshje ndërkombëtare futbolli, i bëmë dy televizorë në sallonin e shtëpisë.

“Ndërroje kanalin grua e qitma futbollin!”, i thashë.

“Le që je bërë dembel, por edhe nuk po sheh se jam kah e shikoj Miranin”, ma ktheu ashpër.

“Ç’lidhje ka kjo?”, e pyeta unë.

“Është një ngjarje për dashuri dhe normalisht që ka shumë lidhje. E, çka ka lidhje futbolli yt, ku çdo ditë shikon futboll?! Të është mbushur koka vetëm futboll!”.

“Mirë e ke, sepse më për dashuri nuk flet askush, pos në serialet tua. Madje, edhe kryeministri është çoroditur dhe po flet vetëm për suksese, thuajse e ka bërë nami... Mirë do të ishte ta ndër-ronte temën edhe kryeministri, sepse vetëm po lavdërohet e numri i të infektuarve me Covid-19 në Kosovë, vetëm gjatë ditës së djeshme, e kaloi shifrën 1000, konkretisht 1008 të infektuar brenda një dite!

Dhe, nëse një burrë lavdëron veten, i bie sikur ezani i imamit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë, të cilin më mirë është të mos e dëgjosh fare kur e thirr ezanin, sepse e thërret aq keq dhe pa lidhje sa nuk të qon mall hoxhe”, i thashë gruas, e cila në ato çaste as që kishte qenë duke më dëgjuar.

Nejse, e nisa me diçka tjetër dhe dola dikur tjetër... Prandaj, të kthehem përsëri te gruaja. Ajo filmin - unë futbollin! E mora televizorin nga dhoma tjetër dhe e vendosa pranë televizorit tjetër. Dy televizorë në një dhomë, madje mbi të njëjtën tavolinë... Unë futbollin ajo Miranin.

“Uh, po kollaj paska qenë ta zgjidhim problemin!”, i them gruas. “Për pak s’u zumë, e zënka kushedi çfarë do të kishte pasuar: shi, breshër, borë...”.

“Edhe unë do ta kisha dëgjuar kryeministrin po të fliste edhe për dashuri dhe jo vetëm për sukseset e tij, thuajse Kosova është bërë

xhenet!”, më thotë ajo me zë të lartë.

“Po, ama, si të flet për dashuri i pari i qeverisë, grua?!”, i them.

“Epo, nëse do ta dëgjojë dikush le të flasë për aso temë!”, më thotë ajo.

“Po flet kështu për kryeministrin grua?! Ti vetë ia ke dhënë votën! E, tash çka po ndodhë me ty?!”, ia ktheva unë.

“Asgjë nuk po ndodhë, por nga qeveria, po e sheh edhe vetë se si dalin në televizor, flasin për suksese e numri i të infektuarve nga Covid-19 po rritet më shumë se çdo kund tjetër në Ballkan!”, ma ktheu ajo.

“Eh, mirë që i ke ra pishman se kur të thoshte shoqja jote jepja LDK-së, ti thoshe jo, sepse “Vetëvendosja” tash është në trend. Pra, ja pafsh hajrin!”.

## KUSH IA VODHI GRUAS SIME ÇANTËN?

E enjtja që e lamë pas ishte një ditë si zakonisht.

“Ditë e re, fat i ri, thotë mileti, a po jo grua?”, i thashë sapo u zgjuam, kur ajo po i bënte kafetë e mëngjesit.

“Po, ashtu thonë, vetëm se një fjalë duhet ndërruar... Fjalën milet e bëjmë popull”, më thotë ajo.

“Eh, mendova se më lehtë e kupton ti, meqë po i shikon filmat turk, por ke të drejtë. Edhe Fan Nolin e kishin pas kritikuar me përdorim të tepruar të fjalëve të huaja në poezi, sepse po të kishin shkruar të gjithë si ai do ta kishin vënë në rrezik gjuhën shqipe”.

“A ja nise me filozofua, a?!”, ma ktheu me ironi.

“E lëmë me kaq: “Dita e re, fati i ri”. Ama, nuk i dihet jetës. Në vend të fatit shumë herë vjen diçka tjetër, sikur në poezinë e poetit arbëresh Vorea Ujko, ku vajzës që priste vdekjen i kishte shkrepur fati i mrekullueshëm”.

“Ti me poezi e nis ditën, si Kryeministri ynë me lavde!”, prapë me ironi ma kthen ajo.

Nejse, ajo shkon në punë me

veturë, kurse unë në punë me veturën time. Pas orës 12 më bën zile dhe më thotë se ia kanë thyer veturën. Ia kanë marrë çantën me çdo gjë që ka pasur në të: paratë, dokumentet personale, ato të veturës... Plus xhami i thyer i veturës... Eh, thash me vete, ajo që unë i thashë është pjesë e jetës...

## DASHURIA E PARË, PUTHJA E PARË...

“Gjërat e para çdo herë janë më të vështira, por pastaj mësohet njeriu me to. Për shembull, grua, a të kujtohet dashuria e parë? Puthja e parë?

Me siguri, këto dy gjëra i kujton me ëndje... të është dukur sikur po ecë nëpër re...”.

“Lëri ato pallavra, alla hile! Po ku sheh gjë të mirë te ne?”, ma kthen me plot nervozë.

“Eh, duhet t’i kesh sytë e qeveritarëve, moj grua, për të parë gjëra të mira, jetë të mirë... Nuk mundet çdo kush të sheh mirë e bukur. Nuk është pranverë për çdo kënd, por vetëm për ata që dinë të dredhojnë...”, ia ktheva me tallje, sepse e pash se gjërat po thellohen.

## PSE GJITHMONË KUR SHIKOJ ORËN ËSHTË AKREPI MBI AKREP?

Momente të mira janë edhe kur zë syri akrepin e orës mbi akrep. Po, unë, në fakt, qenkam në këtë shenjë horoskopi. Akrep jam. Nuk di çka simbolizon akrepi mbi akrep, por ma kënda t’i shoh njërin mbi tjetrin...

“Ja me çka ushqehen disa njerëz, i them gruas, edhe me akrepat e orës, si unë... Ndoshta, pse kur isha i ri mendoja se po ta shohësh akrepin mbi akrep do të kesh fat në dashuri... Fat në puthje...”.

“Po-po, vetëm te dashuria dhe puthja e parë i mban mend ti!”, ma ktheu ajo, me gëzim e saj sikur më zuri ngushtë dhe s’kam kah t’ia mbaj.

**Sokol Murturi**

*Dua të mos më gjyko-  
ni për jetën time dhe  
gjërat që kam bërë,  
por t'më kuptoni. Po e  
shkruaj këtë histori,  
që vajzat si unë të be-  
sojnë se, ndoshta, një  
ditë, mund ta gjejnë  
princin e kaltër dhe  
ajo ditë nuk është  
shumë e largët. Dua  
që vajzat si unë të  
mos ndjehen të pash-  
presa, por të shohin  
larg dhe të mendojnë  
se edhe për to Zoti ka  
rezervuar një kapitull  
të bukur, një jetë të  
bukur dhe normale...*

Jam studente në vitin e dytë master. Pesë vjet më parë kam ardhur në Prishtinë për t'i ndjekur studimet. Origjina ime është nga Gjakova dhe atje të gjithë e dinë sesa të varfër dhe të mjerë janë njerëzit pas lufte. Gjithsesi, prindërit e mi me sakrificë pranuan që t'më lejojnë të studioja në Prishtinë. Isha një nxënëse e mirë dhe fitova degën që dëshiroja. Përpara se të nisesha për në fakultet prindërit më dhanë porositë, ku përveçse duhet të studioja, të kujdesesha që shpenzimet e mia të ishin sa më të ulëta, e porosia kryesore e nënës ishte ta ruaja nderin. Fillimisht këtë e bëra, derisa një ditë njoha një djalë, një djalë të keq. Në fillim ai më merrte me shoqërinë e tij, më prezantonte me njerëz të ndryshëm, kryesisht meshkuj që ishin shumë më të mëdhenj se unë në moshë, por edhe më të mëdhenj se i dashuri im. Një ditë ai kërkoi që të dilja me një shok të tij.



## Tek pasi tentoi t'më dhunonte u dashurova në të!

"Do kënaqesh, vetëm do kërceni në diskotekë. Ai do një shoqe që të bëjë figurë të mirë në sy të miqve të tij, vetëm kaq. Nuk do të prekë, ki besim, ai është shoku im më i mirë", më tha. Pranova, por ajo mbrëmje nuk do të ishte ashtu si ai ma kishte përshkruar. Shoku i tij, fillimisht, më prekte me duar dhe më bënte me shenjë që të buzëqeshja. E bëra këtë derisa ai më mori të kërcenim dhe më tha se nuk duhet të reagoja dhe se duhet të bëja gjithçka që donte ai dhe thoshte ai.

### U MUNDUA T'MË DHUNONTE...

U puthëm gjatë gjithë mbrëmjes, më prekte ngado. U përpoqa të lidhesha me të dashurin tim, por ai nuk e hapte telefonin. Si përfundim ikëm nga diskoteka. Shoku i të dashurit tim më tha se do t'më shoqëronte me veturë. Hipa në veturë dhe u skuqa komplet nga turpi, nga inati dhe ndjenja e fajit. Ai qeshi, i dha gaz veturës dhe u gjendem në rrugë. Vetura nuk po ecte më në drejtim të shtëpisë sime, por në një rrugë tjetër, që unë nuk e kisha parë më parë. Ai më tha mos të shqetësohesha... Në fakt, nuk kisha

shumë frikë, pasi i dashuri im më tha se ishte shoku i tij më i mirë dhe ai nuk mund t'ia bënte këtë shokut të tij. Por, në një rrugicë të ngushtë dhe të errët, ai ndaloi veturën. Unë me ngulm kërkova që të shkonim në shtëpi se isha e lodhur dhe ishte vonë. Dhe, pa një e pa dy dola nga vetura dhe u nisa rrugës në këmbë. Pasi bëra goxha rrugë ai më zuri me veturë dhe më tha të hyja në veturë se do më dërgonte drejt e në shtëpi. Për çudi, i besova... Dhe, ashtu ndodhi...

### PAS NJË VITI E KËRKOVA VETË...

Më nuk u takuam një kohë të gjatë, sepse e urreja, por me kohë ndieja nevojë të jem pranë tij, meqë nuk më hiqej nga mendja përjetimi i asaj nate në errësirë. Dhe, një vit më pas e kërkova vetë. E gjeta dhe u habit kur më pa. E, kur i thashë se dua të jem me të, ai vetëm më buzëqeshi dhe më përqafoi fort e fort... Sivjet në vjeshtë, kësmet, planifikojmë të bëjmë dasmë. Prandaj, jam bindur se në jetë po ndodhkan edhe gjëra të pabesueshme...

D.





# Giovanni's Beach

## COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin    [www.touristcamping.me](http://www.touristcamping.me)    Tel: +38269336233





Flet  
25-vjeçari...

# Shefja ime është dashuruar në mua!

*25-vjeçari nga Prishtina tregon se një natë, kur edhe ishte kujdestar në klinikën ku punon, shefja e tij, e martuar dhe me fëmijë, i afrohet dhe kërkon të putheshin..*

Vitin e kaluar, kur isha kujdestar në repartin ku punoj, në orët e vona të natës të gjithë flinin, me përjashtim timin dhe shefes sime, e cila edhe ajo ishte kujdestare.

Në një moment ajo mu afrua, m'i ledhatoi faqet dhe më puthi në buzë. Unë, në çast u skuqqa, sepse mu ngritë tensioni nga veprimi i saj i papritur.

Sepse, një gjë të tillë nuk e kisha menduar as në ëndërr, por ja që më erdhi si prej qielli, siç thuhet në popull.

Pas pak më tha të shkoja në zyrën e saj dhe të prisja aty. Pa u hamendur shkova dhe u ula në kolltukun ku uleshin pacientët a mysafirët.

Dhe, nuk vonoi shumë e Ajo erdhi. E mbylli derën me çelës. Tashmë unë duhej ta bëja timen, t'i afrohesha... Dhe, një gjë e tillë ndodhi. Lu hodha në përqaftim, u puthëm, u deshëm, u kënaqëm thuajse një gjysmë ore dhe shpejt e shpejt u veshja dhe dola ngadalë, duke shikuar se mos ndodhej kush në korridor.

Atë natë më nuk e pash dhe as që guxoja t'i dilja para syve. Të nesërmen në mëngjes unë pak më herët se zakonisht e dorëzoja ndërrimin, ndërkaq ditën tjetër, kur erdha në punë, pas një përhëndetjeje me shefen time, në korridor më tha: "Ajo që ndodhi atë natë mbetet për atë natë dhe nuk përsëritet më!"

Unë, nga frika se mos do hakmerrej, vetëm rrudha krahët dhe heshta. Dhe, ajo heshtje po ndodhë që rrafsh një vit, edhe pse tash unë jam dashuruar marrëzisht në të, por s'kam guxim t'ia them.

R.

Radio,  
Lajme, Moti,  
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin  
**Shkabaj** për Android



 **Shkabaj**  
www.shkabaj.net



# remos®



Aachener Straße 21 | Köln  
Ulmenstraße 30 | Frankfurt  
Westerwaldpark 4 | WW  
Bahnhofplatz 5 | Koblenz  
[remos-restaurants.de](https://remos-restaurants.de)



  
[remos\\_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)





Dikur e afirmuar...

# A u kujtohet Valentina Rama?

Valentina Rama ishte këngëtare e pëlqyer vite me radhë. Pati disa hite, por e la muzikën, për të mos u rikthyer më asnjëherë në skenë.

Këngëtarja nga Drenica nuk jeton më në Kosovë, pasi prej vitesh jeton në Suedi, ku edhe punon.

Ajo është martuar dhe është bërë nënë e një djali. Pra, jeta e saj ka ndryshuar tërësisht...

## Ish-gruaja e futbollistit shqiptar nga Maqedonia nuk e ndal lezetin!

*Erjona Sylejmani për publikun është bërë më e njohur pas martesës me futbollistin Blerim Xhemajli, e me të cilin ka një djalë.*

Erjona tash është njëra prej modeleve shqiptare që tërheqë vëmendje të madhe sa herë që publikon imazhe në rrjetet sociale.

Megjithatë, prej kohësh, ish-bashkëshortja e futbollistit Blerim Xhemajli, Erjona Sylejmani, po e shijon lidhjen e dashurisë me protagonistin e "Uomini e Donne", Alessandro Basciano.

Kohë më parë Erjona Sylejmani bëri publike lidhjen

me Bascianon, me anë të disa fotove të publikuara në rrjetet sociale.

Së fundi, ajo ka publikuar imazhe lezeti në krah tij, teksa pozon me të dashurin në Milano të Italisë.

Vlen të theksohet se kjo është lidhja e parë publike e Erjona Sylejmanit pas ndarjes së saj nga futbollisti Blerim Xhemajli, me të cilin ka një djalë.







**DENTFIX**  
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

*Iniciativë e qëlluar...*

# Pse vetura e Bekim Fehmiut nuk dërgohet në muze?

Në oborrin e shtëpisë së Burim Myftiut në Prizren, ndodhet vetura "Pezho 404", të cilën në vitin 1968, aktori kosovar me famë botërore, Bekim Fehmiu, nga honorari i Serialit "TV Odiseja", ia kishte blerë nënës së vet, Hedijes, që ta vizitonte kudo që ai xhironte.

Mirëpo, në vitin 1996, veturën e Bekimit e kanë marrë vëllezërit e tij që ta shfrytëzonin.

Mirëpo, me kalimin e kohës vetura e Bekim Fehmiut është shkatërruar dhe duhet renovimi i saj, jo që të shfrytëzohej, por, siç thotë Burim Myftiu, të jepet për ekspozim në ndonjë hapësirë në qendër të Prizrenit apo në kuadër të Muzeut kushtuar Bekim Fehmiut, që do të duhej të hapej në këtë qytet, si shenjë kujtimi të aktorit të madh.



*Te ne, në Kosovë...*

# Në cilin vend ndodhen "Varret e Krushqve"?



Në Dushkajë të Gjakovës ekziston një legjendë për vendin që quhet "Varret e Krushqve". Ky vend ndodhet ndërmjet fshatrave: Gergoc, Maznik e Kralan. Legjenda thotë se aty janë takuar në rrugë dy krushqi, nga dy dasma të ndryshme dhe janë vrarë me njëri-tjetrit të gjithë. Kur nuk ka mbetur asnjë i gjallë, edhe nusët zbritën nga qerret dhe dolën në dyluftim me njëra-tjetrën.

E gjithë kjo për çfarë?

Vetëm mos t'ia lëshojnë udhën njëri-tjetrit, sepse besohej se udha e krushqve nuk thyhet. Rruga ku ato u ndeshën ishte e ngushtë...

Sot, në ato treva, kur bëhet dasma, kur takohen dy krushqi në rrugë, njëra krushqi ndalet derisa kalon kolona e krushqve të tjerë. Dhe, derisa të ndërrohen në rrugë, shkëmbejnë cigare, përsëhendeten, ia urojnë njëri-tjetrit martesat dhe vazhdojnë udhën...



# Mall, vuajtje e dashuri kam për ty

Sonte ëndrrat dhe kujtimet për ty i kam këtu, grumbulluar në shpirtin tim, në zemrën time.

Më beso, ndihem e vetme në këtë botë të madhe, e humbur si një e huaj në errësirën e harruar dhe e strehuar në një qoshe pa skaj.

Mes ëndrrash që dikur i pata, që jeta m'i ka ofruar njëherë kur isha me ty, e ndjej veten të dëshiruar për pak çaste, e për pak ngrohësi, e për shumë dashuri. Tash në zemrën time mbretëron acari, që më ngriu zemrën, e bëri akull. Sonte shoh një dorë që s'më bindet, shoh dy sy që

të kërkojnë ty, i dashuri im. Ndjej një zemër që, ndoshta, s'më përket mua. Ndjej dashuri që më përpinë krejt trupin dhe, pastaj, shpirtin, mendimin, gjakun, nervat dhe çdo qelizë të qenies sime.

Ti, ndoshta, imagjinon çdo të thotë të duash dikë në heshtje, në këtë largësi të mallkuar...

Të jetosh çdo çast kur një pjesë e qenies tënde jeton larg dhe, aq më keq, kur e di që ende e do.

E, ç'rëndësi ka për mua, veç ekzistencës tënde?! Vetëm njëherë të jem me ty, të qëndroja një minutë, atëherë e kisha

lutur Zotin të më merr në botën tjetër, sepse asaj bote i takoj pa ty!

Eh, sa e sa orë e ditë më ikin duke të menduar ty! Netëve përpëlitëm dhe ndjej shtrëngim në zemër, lotët më rrjedhin pa pushim, derisa dalin rrezet e diellit mbi dritaret e dhomës sime... Ngado që hedh sytë, më duket se të shoh... Shoh buzëqeshjen tënde magjepsëse, buzët e ëmbla, sytë e shkruar... Ngado që hedh dorën të parafytyroj se të prekë...

Dhe, e dashuruar si sot, do të mbetëm në ty gjithmonë...

E.



## *Histori të pabesueshme divorci*

### **GRUAJA NUK DONTË MARRËDHËNIE SEKSUALE!**

Një gjykatë në Tainan pranoi kërkesën për divorc të një burri, i cili pretendonte se e shoqja ishte aq e turpshme, saqë nuk pranonte të kryente marrëdhënie seksuale edhe pas një viti martesë.

Çen, mësues 38-vjeçar, nga Tainani, ishte martuar me 29-vjeçaren Lin, gjithashtu mësuese. Sipas Çenit në natën e parë të martesës ajo fjeti e veshur me fustan dhe e mbështjellë me jorgan.

"Ti je qesharak", iu përgjigj ajo të shoqit, kur ky kërkoi kryerje të marrëdhënieve seksuale. Ajo u rikthye të nesërmen te e ëma.

Lin e kundërshtoi divorcin, duke pretenduar se ajo e kishte refuzuar marrëdhënien natën e parë, sepse ndihej e lodhur, por gjykatësi tha se nuk mund të përdorte të njëjtin justifikim për një vit të tërë martese, duke i dhënë divorcin Çenit.

### **BURRI NUK IA KISHTE PARË FYTYRËN GRUAS 30 VJET!**

Më 2008 në Arabinë Saudite një grua kërkoi divorc, sepse burri i saj u përpoq t'i shihte fytyrën pas 30 vjetësh martesë.

Ai kishte jetuar me të shoqen për 30 vjet me radhë pa i hedhur sytë në fytyrën e saj.

Gruaja 50-vjeçare ndiqte traditën e fshatit të saj të lindjes në afërsi të Khamis Mushajt, duke mbajtur fytyrën të mbuluar gjatë gjithë kohës.

Një natë i shoqi ishte bërë kurioz dhe kishte provuar t'i hiqte burkën ndërsa ajo flinte, në mënyrë që t'i shihte fytyrën, por ajo ishte zgjuar.

Pas kësaj i shoqi i kërkoi falje dhe i premtoi se nuk do ta bënte më kurrë një gjë të tillë, por ajo vendosi të kërkonte ndarjen. Mund të duket e çuditshme, por në Arabinë Saudite, çiftet të tilla të mbështjella nga misteri për njëri-tjetrin nuk janë të pazakonta.

### **BASHKËSHORTJA E KISHTE GËNJYER PËR MOSHËN**

Një grua kineze, e quajtur Luo, e cila gënjeu për moshën, u përballë me kërkesën e bashkëshortit për divorc pas 10 vjetësh martesë. Ajo kishte qenë 30 vjeçe në momentin kur ishte njohur me të shoqin, por i kishte thënë atij se ishte 24. Më 2007 i shoqi kërkoi divorc pasi kuptoi se ajo e kishte gënjyer.

### **NUSJA NUK MUND TË HANTE DREKË ME VJEHRRËN!**

Më 2005 një grua rumune kërkoi divorc, sepse nuk mund të duronte faktin e të ngrënit drekë çdo ditë me vjehrrën. Gruaja 22-vjeçare kishte vetëm 10 muaj e martuar kur u ankua se jeta e saj ishte kthyer në një makth shkaku i vjehrrës. Elena T., nga Focsani, në provincën Vrancea, i tha gjykatësit se prania e vjehrrës së saj në vaktin më të rëndësishëm të ditës, duke bërë vërejtje, po ia shkatërronte jetën.



*Benet Nura, nga Kosova, është 19 vjeç. Ai qe tre vjet jetën në Holandë, ku vazhdon studimet për shkenca kompjuterike.*

Emri i Benetit do të mbahet mend nga shqiptarët, meqë ai do të jetë shqiptari i parë që do të shkojë në planetin Mars. Është përzgjedhur nga NASA për të shkuar në planetin Mars dhe përzgjedhja u bë në mesin e 12 milionë njerëzve, që aplikuan për të shkuar në këtë planet.

### SI U PËRZGJODH BENETI TË SHKOJË NË MARS?

Ai aplikoi, dha shënimet dhe fati deshi e u përzgjedh në mesin e 12 milionë njerëzve. Gjithsej do të shkojmë në Mars 100 mijë persona.

Kushti ishte: të jesh i interesuar për shkencë dhe të kesh përfunduar klasën e pestë për shkencë.

Njerëzit e parë do të shkojnë në vitin 2026, më pas do të shkojmë të tjerët me rend. Udhëtimi bëhet për të gjetur jetë ose ujë në atë planet. Udhëtimi nga Toka në Mars do të zgjasë 7 muaj.

# Shqiptari i parë në Mars



## Interesante, a?

# Cili shqiptar i pari pa UFO?



Shqiptari i parë që foli për UFO-t është shkrimtari Mihal Grameno (1907-1908). Në memoaret e tij, ku ruhen edhe fotot e ndryshme të punës së tij, Mihal Grameno, bashkëluftëtar i patriotit Çerçiz Topulli, në librin e tij "Kryengritja Shqiptare", duke folur për çetën e Çerçiz Topullit, nga një mal në tjetrin, pasi has në një mjet të çuditshëm fluturues thotë:

"Një natë, gjersa luftëtarët e Çerçizit po ngrinin një kurth në majë mali, një objekt vezullues fluturoi para nesh e qëndroi në ajër për

disa minuta dhe më pas u zhduk", shkroi Grameno.

Grameno kishte hasur në UFO, por që atëbotë nuk njiheshin me emër të tillë.

Aeroplanët në atë kohë ishin në fazë të hershme, çka përjashtohet si teori. As meteor nuk mund të ishte, meqë ai nuk qëndron në ajër, siç tregon Mihal Grameno. Fjala ishte për një mjet fluturues, e që Mihal Grameno e përshkroi mirë, sa edhe i përshtatet shpjegimit të tanishëm si një fluturake e befasishme.

## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depressive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

*kontaktoni në këtë email adresë:*

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### **Pse humbi dashuria e tij kur u fejuam?**

Përsëndetje zonja magjistare, jam një vajzë e fejuar në mars të vitit të sivjetmë. U fejova me një djalë që jeton në Gjermani. Ai u tregua shumë i kujdesshëm ndaj meje dhe familjes kur erdhi për t'u parë me mua...

E kemi shpallur fejesën dhe e kemi bërë familjarisht lidhjen, por prej kur ka shkuar atje është tepër i ftohët ndaj meje. Më thotë se jemi fejuar me nguti dhe duhet të korrigjohemi...

Çka ndikoi te ai që të zbehet dashuria?

**"Pa shifër"**

### **Përgjigje:**

*Realisht, ju keni folur në rrjete sociale, duke qenë edhe të një rrethi gjeografik. Jeni njohur, por nuk keni qëndruar bashkë për ta ditur vlerën e njëri-tjetrit. Ti i ke pasur dy lidhje para tij në vendin tënd dhe një person i ka ditur të dyja lidhjet tua. Ai ka folur për rastin tënd. Dhe, një gjë të tillë e ka kuptuar*

*edhe familja e të fejuarit tënd. Andaj, edhe nuk është i njëjti qysh ka qenë ndaj teje. Prandaj, shoh se së shpejti edhe do ta prishni fejesën.*

### **Burri po largohet, ndarja po troket në derë!**

Përsëndetje magjistare, jam një zonjë, jetoj në Perëndim. Jam nënë e dy fëmijëve. Dua të mbetëm anonime...

Kam probleme me burrë.

Besoj se ka magji, sepse pa i bërë asgjë është larguar prej meje dhe nuk më ofrohet as mua e as fëmijëve.

Para se të merrte vendim për ndarje, më pat thënë se i është këputur trupi dhe nuk mund të qohet në këmbë. Prej atëherë më nuk është sjellë mirë ndaj nesh. Së fundi, jemi në një proces gjyqësor për ndarje. Kush na solli në këtë gjendje?

### **Përgjigje:**

*Unë shoh se keni pasur shumë konflikte me nënën e tij. Prej*

*kur jeni bashkuar, nëna e tij ka pasur antipati ndaj teje.*

*Antipatinë e saj e ka shkaktuar burri yt, sepse ka qenë shumë i lidhur me nënën.*

*Ai nuk është dashur t'ia përcillte nënës së vet gjërat që u qojnë te ndarja, sepse ju jeni familje.*

*Shoh se ndërmjet jush ka ndikuar edhe dora e keqe. Andaj, nuk shoh se do të ribashkoheni.*

### **A kanë magji fëmijët e mi?**

Përsëndetje zonjë, jam një nënë e tre fëmijëve. Kam pasur probleme me vajzën e madhe, që deshi të lidhej me një të huaj. Nuk e donim të huajin dhe pak para se të martohej na ndihmove ti dhe ajo u nda prej tij.

Me ndihmën tënde ajo gjeti fatin me një djalë shqiptar, për çka të falënderohemi shumë me burrin.

Por, tash e kemi një problem tjetër: Djali i madh më herët ka qenë i sëmurë nga magjia. Kur e pyeta, përgjigja e tij ishte se halla i ka bërë magji. Që nga ai moment frika është përcjellë edhe te vajza, e cila ikë prej hallës së vet dhe të gjithë dyshojmë se ajo merret me këtë punë. A është e vërtetë kjo, apo ne jemi gabim?

**"Nëna e tre fëmijëve"**

### **Përgjigje:**

*Sipas asaj që shoh unë, djali ka pasur një problem të natyrës psikiatrike, që ka ardhur nga frika. Dhe, pasi është vërejtur*



*shqetësimi i tij psikik, ai e ka gjuajtur gurin te dikush sa për ta arsyetuar veten dhe, pastaj, këtë problem e ka ndërlidhur me hallën.*

*Kjo nuk është e vërtetë aspak. Ti, a do i bëje keq djalit të vël-lait tënd? Me siguri, jo. Sepse, bijat mezi presin ta shohin mirë familjen. Aty ku janë lindur e rritur, aty edhe shkojnë me dëshirë e vullnet...*

*Andaj, është keq kur dikujt ia ngarkoni problemin personal dhe familjar, diçka që te mentaliteti ynë ndodh me të madhe. Prandaj, u them me shumë bindje që të mos frikësoheni nga halla dhe ta doni atë, sepse nuk ka asgjë të vërtetë prej kësaj pune.*

## **Çka do të ndodhë me fatin tim, pas 12 vjet martesë?**

*Të përshëndes nga zemra motër e dashur! Jam një zonjë, 35-vjeçare. Ka dy muaj që jam ndarë nga burri. Fëmijë nuk kam.*

*Ai gjeti një tjetër. U arsyetua se martohet për fëmijë, por lidhja e tyre kishte qenë e vjetër. Dhe, pasi nuk pranova të jetoj me të, u ndamë, e ai dashnoren e mori grua. Jam e mërzhitur shumë... Kam filluar të takohem me një person, por...*

*Si do të rrjedhë fati im tash?*

**"E palumtura"**

## **Përgjigje:**

*Ka me qenë shumë interesant fati yt tani e tutje. Ti ke pasur*

*një lidhje me një person në shkollën e mesme, por nuk jeni bashkuar për shumë arsye. Ke për t'u takuar me atë person rastësisht, nëpërmjet një shoku të klasës dhe keni për ta aktivizuar lidhjen.*

*Ai është i martuar, ka fëmijë, por fati është i çuditshëm dhe mund ta bëjë të veten në rastin tuaj.*

## **Jam e dashuruar, por ai nuk e di!**

*Zonjë e bekuar, besoj nuk ma zëni për të madhe këtë gjendje në të cilën kam rënë, prandaj shpresoj të më ndihmoni me këshillat tuaja, apo t'më tregoni si të vij te ai...*

*Jam 39-vjeçare, punoj në një administratë publike në Prishtinë. Ka dhjetë vjet që punoj me një person dhe nuk kemi ende asgjë.*

*Nga ana e sjelljes çdo gjë është korrekte dhe nuk mund ta fajësojë atë për asgjë. Por, unë jam dashuruar në të, sa nuk më zihet vendi-vend.*

*Më duhet në çdo moment të jem me dikë, sepse më duket vetja tepër e vetmuar. Për të qenë korrekte, jam një grua e ndershme dhe asnjëherë se kam tradhtuar burrin dhe vetëm në këtë rast do ta bëja një gjë të tillë...*

*Ai nuk e di se unë jam e dashuruar në të, nuk i jam ofruar kurrë, pos që e shikoj*

## **PËR LEXUESIT E DIASPORËS**

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

*me kureshtje...*

*A ka mundësi që ai e di se unë e dua? Dhe, nëse i them, a ka rrezik se do ta shkatëroj familjen time?*

**"Brenda b"**

## **Përgjigje:**

*Syri flet shumë. Në fakt, çdo gjë në jetë fillon nga syri. Syri është një dritare e shpirtit, nga e cila shihet çdo gjë që ndezë brendësinë e tij dhe nga syri nis çdo gjë.*

*Përditshmëria e shikimeve ka dozë magjie, që gravitojnë refleksione, e që mund të përfundojnë në dashuri, si në rastin tuaj.*

*Por, nuk është e vërtetë që ai nuk e di. Ju, vetëm duke qenë duet, e keni ndërtuar këtë ndjenjë dashurie...*

*Për të mos u marrë shumë me shpjegimin e këtij fenomeni, edhe pse ju jeni produkt i tij, ti je para dy akteve të mundshme:*

*Një, ose do të jesh me të; Dy, ose duhet ta ndërrosh vendin e punës, duke u larguar prej asaj zyre, e që ke mundësi ta bësh.*

*Megjithatë, imja është të të them se ke për ta rrezikuar bashkëshortësinë nëse futesh në lojën e dashurisë me të...*



# Cilat janë shenjat e Horoskopit më me fat sivjet?

*Astrologët kanë parashikuar shenjat e Horoskopit që do të ndihen më me fat sivjet. Cilat janë ato?*

## **BINJAKËT**

Binjakët janë me shumë fat. Në të njëjtën kohë, sukcesi vlen si për jetën personale ashtu edhe për karrierën. Binjakët mund të tërhiqen nga ndryshimet dhe kjo do t'u sjellë dobi vetëm atyre.

Ndryshimet drastike do të përmirësojnë kushtet financiare. Gushti është muaji më i favorshëm për krijimin e marrëdhënieve të reja ose transferimin e asaj ekzistuese në një nivel të ri.

## **PESHORJA**

Është e mundur që Peshorja do të takojë dashurinë e vërtetë gjatë verës. Përveç kësaj, kjo periudhë do të ndikojë pozitivisht në harmonizimin e marrëdhënieve familjare.

Sipas parashikimeve, në fund të gushtit, Peshorja do të ketë bollëk monetar.

## **AKREPI**

Për Akrepat, kjo verë do të jetë një nga më të lumturat. Më në fund, do të jeni në gjendje të përmirësoni jetën tuaj të dashurisë.

Sipas astrologëve, këta persona do të gjejnë dashurinë apo përmirësojnë një raport romantik të krijuar tashmë.

Deri në fund të sezonit veror, përfaqësuesit e kësaj shenje do të kenë një "erë të dytë" në punën e tyre dhe, më në fund, do të arrijnë atë që kanë ëndërruar prej kohësh në karrierë.





# SHERWOOD

*Resorts and Hotels*

*Feel the Legend*

**SHERWOOD  
EXCLUSIVE KEMER**  
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD  
EXCLUSIVE LARA**  
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD  
DREAMS RESORT**  
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE  
BELEK**  
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD  
SUITES RESORT**  
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD  
GREENWOOD RESORT**  
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD  
PRIZE HOTEL**  
LARA / ANTALYA

+90 242 444 88 07  
www.sherwoodhotels.com.tr

